



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M
K.P.P. 160/2020

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 05.05.2020, shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë “Alba Konstruksion” sh.p.k. & “4 A-M” sh.p.k., në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me nr. REF- 44912-11-26-2019, me objekt “*Ndërtimi i Godinës së Re të Ujësjellësit*”, me fond limit 480.000.551,56 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 06.01.2020, nga autoriteti kontraktor, Ujësjellës Kanalizime sh.a. Tiranë.

Ankimues: Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Alba Konstruksion” sh.p.k. & “4 A-M” sh.p.k.
Rruga “Frederik Shiroka”, Pallati i ri, shkalla B, Kati 2, Tiranë

Autoriteti Kontraktor: Ujësjellës Kanalizime Sh.a. Tiranë
Rr.Kavajës Nr.133, Nj. Adm Nr.6, Kodë Postar 1027, Tiranë

Baza Ligjore: Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “*Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksonimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar;

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar;

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik;

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 27.11.2019 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, në faqen zyrtare të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me nr. REF-44912-11-26-2019, me objekt “*Ndërtimi i Godinës së Re të Ujësjellësit*”, me fond limit 480.000.551,56 lekë (pa TVSH).

II.2. Në datën 06.01.2020, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

Referuar informacionit dhe dokumentacionit të autoritetit kontraktor, në këtë procedurë prokurimi, kanë marrë pjesë operatorët ekonomikë si më poshtë, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH) përkatësisht:

1. Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Kevin Konstruktion” sh.p.k.
& “Curri” sh.p.k. & “B - 93” sh.p.k. 340.778.441 lekë, skualifikuar

- | | | |
|----|--|-----------------------------------|
| 2. | “Salillari” sh.p.k. | 407.899.066 lekë, skualifikuar |
| 3. | “Sireta 2F” sh.p.k. | 424.823.012 lekë, skualifikuar |
| 4. | Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Alba Konstruksion” sh.p.k.
& “4 AM” sh.p.k. | 465.623.007 lekë, skualifikuar |
| 5. | “Ante Group” sh.p.k. | 477.593.001,75 lekë, skualifikuar |
| 6. | “Gjikuria” sh.p.k. | 479.950.172,8 lekë, skualifikuar |
| 7. | “Air Komponent” sh.p.k. | nuk ka paraqitur ofertë ekonomike |
| 8. | “Elda - VI” sh.p.k. | nuk ka paraqitur ofertë ekonomike |
| 9. | “Senka” sh.p.k. | nuk ka paraqitur ofertë ekonomike |

II.3. Në datën 17.01.2020 operatori ekonomik ankimues është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi me arsyet si më poshtë vijon:

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në mbështetje të Nenit 53 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për Prokurimin Publik”, (i ndryshuar), dhe të Kreut VII Nenit 66 pikës 3 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, I ndryshuar si dhe dokumentave të tenderit të miratuara, vijoi me shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertës së paraqitur nga ky bashkim Operatorësh Ekonomikë, nga ku rezultoi si më poshtë:

Së pari AK ka kërkuar në kriteret e veçanta të kualifikimit kapaciteti teknik pika 16 si më poshtë cituar:

16.Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratë (Shtojca 10). Mjetet Sasia Gjendja Kamion vetëshkarkues (kapaciteti mbajtës minimum 5(pese) ton dhe maksimumi 10(dhjetë) ton për secilin kamion 8 copë Pronësi ose me qera Kamion vetëshkarkues (kapaciteti mbajtës minimum 12(dymbëdhjetë) ton dhe maksimumi 17(shtatëmbëdhjetë) ton për secilin kamion 5 Cope Pronësi ose me qera Kamion vetëshkarkues (kapaciteti mbajtës minimum 25 ton 4 cope Pronësi ose me qera Eskavator me zinxhir 0.25 m3 2 Cope Pronësi ose me qera Eskavator me cekic 2 cope Pronësi ose me qera Kamionçine (kapaciteti mbajtës minimum 1.5 (nje pik pesë) ton dhe maksimumi 2(dy) ton për secilin kamionçinë 8 cope Pronësi ose me qera Fadrome me goma 2 copë Pronësi ose me qera Eskavator me goma 0.25 m3 2 copë Pronësi ose me qera Sonde shpimi ø600mm deri ne 20m 1 cope Pronësi ose me qera Autobot uji 2 copë Pronësi ose me qera Automjet per mbjellje bari 1 cope Pronësi ose me qera Autobetoniere 4 copë Pronësi ose me qera Autopompe Betoni 2 cope Pronësi ose me qera Autovinc 3 cope Pronësi ose me qera Pompe suvatimi 2 cope Pronësi ose me qera Pompë Uji 2 cope Pronësi ose me qera Rrul ngjeshes deri ne 2 Ton 2 cope Pronësi ose me qera Makineri per shtresa betoni 1 cope Pronësi ose me qera Paisje per ngjitjen e tubave metalik 1 cope Pronësi ose me qera Bobcat 2 cope Pronësi ose me qera Minieskavator me zinxhir gome 2 cope Pronësi ose me qera Minifadrome 1 cope Pronësi ose me qera Vibrator 6 cope Pronësi ose me qera Matrapik 6 cope Pronësi ose me qera Trapan 4 cope Pronësi ose me qera Moto/gjenerator 3 cope Pronësi ose me qera Makine per ngjitje tubash HDPE

2 cope Pronësi ose me qera Saldatrice 4 cope Pronësi ose me qera Paisje per pastrim dhe lucidim pllakave dhe mermerit 1 cope Pronësi ose me qera Paisje ndricimi per kantier 1 cope Pronësi ose me qera Kompaktor ngjeshes 3 cope Pronësi ose me qera Kompresor ajri 3 cope Pronësi ose me qera Makineri CNC per prerjen te formave te crregullta 1 cope Pronësi ose me qera Bango per profilet e aluminit 1 cope Pronësi ose me qera Tranxhe 2 cope Pronësi ose me qera Kalander 2 cope Pronësi ose me qera Skela 2500 m2 Pronësi ose me qera Vinc Karrel 3 Cope Pronësi ose me qera UPS 200KVA 2 cope Pronësi ose me qera Zyrë kantieri e lëvizeshme 2 cope Pronësi ose me qera Nyje inerte dhe prodhim betoni 1 cope Pronësi ose me qera Te paraqiten mjete dhe pajisje të mbrojtjes në punë të punëtorëve, personelit si më poshtë: y) Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik, Çertifikatë për transport mallrash për llogari të vetë dhe siguracionin e mjetit (te vlefshme), dhe per mjetet e siguruara me qera, dokumenti qe verteton regjistrimin e tij plus certifikaten e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit,(te vlefshme) Çertifikatë për transport mallrash për të tretë dhe me qera brenda vendit, duhet te shoqerohet me kontraten perkatese te qerases/furnizimit, e vlefshme per te gjithë periudhen e realizimit te kontrates objekt i ketij prokurimi. Në rastin e mjeteve te tjera duhet te jene aktet e çdoganimit ose faturat tatimore te blerjes. z) Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre.

aa) Për mjetet e marra me qera të të paraqitet kontrata përkatëse noteriale e qirasë ku të specifikohet objekti i kontratës dhe afati i saj.

bb) Per fabriken e prodhimit te betonit, ne rast se eshte ne pronesi duhet te paraqitet akti i pronesise i shoqeruar me leje mjedisore leshuar nga QKL. Ne rast se operatori ekonomik ka kontrate qeraje duhet te paraqitet akti i pronesise se qiradhensit shoqeruar me lejen mjedisore leshuar nga QKL. Kontrata e qerases duhet te jete e noterizuar, ku të specifikohet objekti i kontratës dhe afati i saj. ç) Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.

dd) Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruara sipas shtojcës Nr. 10. (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese).

ee) Makineritë e mësipërme nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera dhe nuk janë të deklaruara ne procedurat te shpallura fitues nga autoriteti kontraktor, UKT sha. (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese ku te deklarohet dhe vendndodhja e mjeteve ne pronesi ose me qera me qellim verifikimi).

ff) (opsion) Do të organizohet një vizitë në kantier deri në date 16.12.2019 në mënyrë të tillë që Operatorët Ekonomikë të mund të familiarizohen me kushtet lokale. Operatori i interesuar Ekonomik duhet të konfirmojë paraprakisht me shkrim synimin e tij për të marrë pjesë në këtë vizitë. Gjatë vizitës do t'u jepen informacione shitesë e shpjegime. Të gjitha kostot e Operatorëve Ekonomikë që lidhen me vizitën në kantier duhet të mbulohen nga vetë ata. Pa paragjykuar sa më sipër, dhe me kostot e risqet e veta, një operator ekonomik mund t'a vizitojë në çdo kohë vendndodhjen e kantierit, nëse një gjë e tillë është e mundur. Për të organizuar një vizitë në kantier, ju lutem drejtoni nje shkrese prane Drejtorise se Prokurimit UKT sha.

Bashkimi i Operatoreve Ekonomik "4 AM" sh.p.k & "Alba Konstruksion" sh.p.k kanë deklaruar në shtojcën nr.10 se disponon mjetet e mëposhtme: Per te permbushur kriterin kamionçinë me kapacitet mbajtes min 1,5 ton- max 2 ton per secilin kamioncinë (8 cope) operatorët ekonomikë kanë paraqitur mjetet e mëposhtme: - Kamionçinë me targa AA367NS me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 2,26 ton paraqitur nga operatori ekonomik 4AM sh.p.k. - Kamionçinë me targa AA882PM me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 2,02 ton mjet i cili do të konsiderohet i rregullt dhe do të futet në kategorinë e mjeteve min 1,5 ton –max 2 ton. - Kamionçinë me targa AA053XC me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 1,4 ton paraqitur nga operatori ekonomik 4AM sh.p.k. - Kamionçinë me targa AA955RP me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 1,8 ton paraqitur nga operatori ekonomik 4AM siguruar nëpërmjet kontratës së qerasë Nr.10404/Rep,Nr.1659/1 Kol. - Kamionçinë me targa AA522JB me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 1,5 ton paraqitur nga operatori ekonomik 4AM siguruar nëpërmjet kontratës së qerasë Nr.10405/Rep,Nr.1660/1 Kol. - Kamionçinë me targa AA852OZ me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 1,61 ton paraqitur nga operatori ekonomik 4AM siguruar nëpërmjet kontratës së qerasë Nr.10406/Rep,Nr.1661/1 Kol. - Kamionçinë me targa TR7649P me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 1,52 ton paraqitur nga operatori ekonomik 4AM siguruar nëpërmjet kontratës së qerasë Nr.10406/Rep,Nr.1661/1 Kol. - Kamionçinë me targa AA233MN me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 1,52 ton paraqitur nga operatori ekonomik 4AM siguruar nëpërmjet kontratës së qerasë . - Kamionçinë me targa AA657JY me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 1,53 ton paraqitur nga operatori ekonomik 4AM mjet i cili do të konsiderohet i rregullt dhe do të futet në kategorinë e mjeteve min 1,5 ton-max 2 ton. - Mjeti me targa TR5800B me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 1 ton paraqitur nga operatori ekonomik Alba Konstruksion sh.p.k. - Kamionçinë me targa AA169RP me kapacitet me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 1,85 ton paraqitur nga operatori ekonomik Alba Konstruksion sh.p.k mjet i cili do të konsiderohet i rregullt dhe do të futet në kategorinë e mjeteve min 1,5 ton-max 2 ton. Komisioni i Vlerësimit të ofertave gjatë shqyrtimit të dokumentacionit në sistemin elektronik për mjetet me targa AA955RP,AA522JB,AA852OZ,TR7649P ,AA233MN (mjete të siguruara me kontrata qeraje nga operatori ekonomik 4 AM sh.p.k) vëren se në përmbushje të kushteve të veçanta të kualifikimit të kërkuar në DST operatori ekonomik ka paraqitur leje qarkullimi, çertifikatë e kontrollit teknik, ,taksë vjetore,foto të mjetit si dhe çertifikatë për transport mallrash për llogari të vet. Ajo çka konstaton Komisioni i Vlerësimit të Ofertave është se çertifikatat e lëshuara për mjetet e mësipërme nga njësia vendore për transport mallrash janë cilësuar "Për llogari të vet, pra qeradhënësi e ka për përdorim vetjak. Dhënia e tyre me qera është në kundërshtim me përcaktimet në nenin 81, pika 1,2,3,4,5 dhe 7,8 "Destinacioni dhe Përdorimi i Mjeteve" i ligjit nr.8378 datë 22.07.1998 "Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, në nenin 3, paragrafi 3.13 dhe 3.14 të Ligjit nr.8308, datë 18.3.1998 për "Transportet rrugore", si dhe në nenin 41, të Ligjit nr.8308, datë 18.3.1998 për "Transportet rrugore", ku parashikohet se: "Transporti i mallrave me qira dhe për të tretë është i ndaluar të kryhet pa licencën përkatëse.

Sa më sipër cituar bashkimi i operatoreve ekonomik nuk e përmbush kriterin e përcaktuar nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit për: - Paraqitjen e 8 mjeteve me kapacitet mbajtës min 1,5 ton dhe max 2 ton pasi nga 8 mjete të kërkuara nga AK kanë paraqitur vetëm 3 mjete të sakta sipas tonazhit dhe dokumentacionit të kërkuar. Për të përmbushur kriterin me kapacitet mbajtës min 5 ton- max 10 ton për secilin kamion vetëshkarkues (8 cope) operatorët ekonomikë kanë paraqitur mjetet e mëposhtme: - Mjeti me targa AA465 PC me kapacitet mbajtës cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 11,2 ton. - Mjeti me targa AA469PC me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 4,9 ton. - Mjeti me targa AA718VL me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 9,3 ton mjet i cili do të konsiderohet i rregullt dhe do të futet në kategorinë e mjeteve min 5 ton-max 10 ton. - Kamion vetëshkarkues TR3878K me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 7,76 ton mjet i cili do të konsiderohet i rregullt dhe do të futet në kategorinë e mjeteve min 5 ton-max 10 ton. - Kamion vetëshkarkues TR3717P me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 8,2 ton mjet i cili do të konsiderohet i rregullt dhe do të futet në kategorinë e mjeteve min 5 ton-max 10 ton. - Kamion vetëshkarkues AA025RK me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 10,03 ton mjet i cili do të konsiderohet i rregullt dhe do të futet në kategorinë e mjeteve min 5 ton-max 10 ton. - Kamion vetëshkarkues AA106MR me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 8,7 ton mjet i siguruar nëpërmjet kontratës së qerasë nga operatori ekonomik 4 AM sh.p.k. - Kamion vetëshkarkues AA908 me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 7,6 ton mjet i siguruar nëpërmjet kontratës së qerasë nga operatori ekonomik 4 AM sh.p.k. - Kamion vetëshkarkues AA853ND me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 8,95 ton mjet i cili do të konsiderohet i rregullt dhe do të futet në kategorinë e mjeteve me kapacitet min 5 ton- max 10 ton. - Kamion vetëshkarkues TR0715T me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 9,24 ton mjet i cili do të konsiderohet i rregullt dhe do të futet në kategorinë e mjeteve me kapacitet min 5 ton- max 10 ton. - Kamion vetëshkarkues TR5923S me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 8,75 ton paraqitur nga operatori ekonomik Alba Konstruksion sh.p.k mjet i cili do të konsiderohet i rregullt dhe do të futet në kategorinë e mjeteve me kapacitet min 5 ton- max 10 ton.

Komisioni i Vlerësimit të ofertave gjatë shqyrtimit të dokumentacionit në sistemin elektronik për mjetet me targa AA106MR, AA908 mjete të siguruara me kontrata qeraje nga operatori ekonomik 4 AM sh.p.k) vëren se në përmbushje të kushteve të veçanta të kualifikimit të kërkuar në DST operatori ekonomik ka paraqitur leje qarkullimi, çertifikatë e kontrollit teknik, ,taksë vjetore,foto të mjetit si dhe çertifikatë për transport mallrash për llogari të vet. Ajo çka konstaton Komisioni i Vlerësimit të Ofertave është se çertifikatat e lëshuara për mjetet e mësipërme nga njësia vendore për transport mallrash janë cilësuar “Për llogari të vet, pra qeradhënësi e ka për përdorim vetjak. Dhënia e tyre me qera është në kundërshtim me përcaktimet në nenin 81, pika 1,2,3,4,5 dhe 7,8 “Destinacioni dhe Përdorimi i Mjeteve” i ligjit nr.8378 datë 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, në nenin 3, paragrafi 3.13 dhe 3.14 të Ligjit nr.8308, datë 18.3.1998 për “Transportet rrugore”, si dhe në nenin 41, të Ligjit nr.8308, datë 18.3.1998 për “Transportet rrugore”, ku parashikohet se:

“Transporti i mallrave me qira dhe për të tretë është i ndaluar të kryhet pa licencën përkatëse. Sa më sipër cituar bashkimi i operatoreve ekonomik nuk e përmbush kriterin e përcaktuar nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit për: Paraqitjen e 8 mjeteve me kapacitet mbajtës min 5 ton dhe max 10 ton pasi nga 8 mjete të kërkuara nga AK kanë paraqitur vetëm 7 mjete të sakta sipas tonazhit dhe dokumentacionit të kërkuar në DST. Për sa më sipër Dokumentacioni i paraqitur nga .BO”Alba Konstruksion sh.p.k &”4 AM ”sh.p.k është i paplotë pasi nuk ka përmbushur kriteret e Veçanta të Kualifikimit/ Kapaciteti Teknik nuk zotëron kapacitet të mjaftueshem teknik për sa i përket mjeteve për të realizuar kontratën për këtë objekt prokurimi duke mos përmbushur Kriteret e veçanta për kualifikim,

Kapaciteti Teknik dhe profesional, , cka bie në kundërshtim me pikën 1 gërma (a) dhe (b) të nenit 46 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik” i ndryshuar ku përcaktohet se: Operatorët ekonomik, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtëme që AK i vlerëson të nevojshme.....

Pra sa më sipër cituar dokumentacioni i paraqitur nga Operatori Ekonomik lidhur me shtojcën 10, është i paplotë.

Së dyti AK ka kërkuar në kushtet e veçanta të kualifikimit si më poshtë cituar: 17. Ofertuesi duhet të paraqesë autorizim nga prodhuesi/ distributori i autorizuar nga prodhuesi me të cilin prodhuesi /distributori i autorizuar, autorizon ofertuesin të ofertojë këto mallra në këtë procedurë prokurimi. Autorozimi duhet te permbaje te dhena te plota te prodhuesit si: Tel/fax/email. Ofertuesi te paraqese, kataloge ose fragmente te katalogut te prodhuesit per listen e materialeve te meposhtme qe do te ofroje ku te paraqiten te dhenat teknike baze. 1. Bojra 2. Pllakat 3. Paisjet elektrike 4. Kamerat 5. Sistemin e kondicionimit 6. Ndricimi Në përmbushje të kriterëve të kërkuar në DST Komisioni i Vlerësimit të Ofertave vëren se një ndër pjesëtarët ekonomik përkatësisht “4AM”ka paraqitur në sistemin elektronik autorizim distributori për pajisjet elektrike nga Abbi-Esse,për pajisjet ndriçimi autorizim distributori nga Sali Elektrik,për pllakat autorizim distributor nga Delta sh.p.k ,për kamerat autorizim distributor Security Solution &Distribution ,për sistemin e kondicionimit autorizim distributori nga Superior Klima,për mallrat bojra autorizim prodhuesi lëshuar nga Deutchcolor. Në kontratën e bashkëpunimit nr.13 rep dhe 2 kol datë 04.01.2020 me anë të cilës është krijuar bashkimi i operatorëve ekonomike përcaktohen qartë punët që do të marrë secili prej operatorëve ekonomike pjesëmarrës në bashkim. Operatori ekonomik Alba Konstruksion midis të tjerave ka marrë përsipër të realizojë zërat e punimeve në kapitullin A7 të preventivit objekt prokurimi (punime bojatisje në të cilën përfshihen lyerje tavane me bojë hidroplastike, lyerje mure të brëndshme me bojë hidroplastike). Në dokumentacionin e depozituar në sistemin elektronik të app-së nga operatori ekonomik Alba Konstruksion sh.p.k nuk rezulton të ketë paraqitur asnjë autorizim prodhuesi apo distributori për mallrat bojra. Vlen të theksohet se zërat e punimeve që kanë të bëjnë me punimet e bojatisjes janë marrë përsipër të kryhen nga shoqëria Alba Konstruksion sh.p.k dhe për rrjedhojë operatori ekonomik Alba Konstruksion sh.p.k duhej të paraqiste në sistemin elektronik autorizim prodhuesi apo distributori për mallrat bojra. Theksojmë se kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi.

Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë dhe përvojën e duhur, për të zbatuar kontratën objekt prokurimi, si edhe janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit, në mënyrë që edhe vlerësimi të bëhet në përputhje me këtë dokumentacion, pasi ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme, në mbështetje edhe të pikës 3, të nenit 66 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, në të cilën përcaktohet se komisioni verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentat e tenderit. Në shtojcën 12 të DST shprehimisht parashikohet seRastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim. Pra, sa më sipër cituar dokumentacioni i paraqitur nga Operatori Ekonomik lidhur me pikën 17 është i paplotë dhe për rrjedhojë i pavlefshëm. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të pikës 5, të nenit 53, të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për “Prokurimin publik”, i ndryshuar dhe mbështetje të Kreu VII, neni 66, pika 3, të VKM nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e shpall të pavlefshme këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në DST.

Së treti AK ka kërkuar në pikën 8 të kushteve të veçanta të kualifikimit si më poshtë cituar: 7.Të ketë në stafin e punonjesve te pasqyruar ne list pagesat e shoqërisë për te pakten 2 muajt e fundit të pakten 60 (gjashtëdhjetë) punonjës të pajisur me deshmi kualifikimi te sigurimit teknik nga ISHTI ose nga institucione ekuivalente me të si më poshtë: - teknike ndertimi 2 Kategoria II - karpentier 5 Kategoria I - hekurkthyes 4 Kategoria I - murator/suvatues 10 Kategoria I - pllakashtrues 8 Kategoria I - elektrikist 11 3 Punonjës Kategoria IV dhe 8 Punonjës Kategoria III - hidraulik 6 Kategoria II - bojaxhi 7 Kategoria I - punetor duroalumini 5 Kategoria I - montator 2 Kategoria II (Per punonjesit e siperpermendur te paraqiten deshmitte perkatese te kualifikimit te sigurimit teknik, kontratat e punes te vlefshme) Bashkimi i operatorëve ekonomikë kanë nënshkruar marrëveshjen e bashkëpunimit nr.13 rep dhe 2 kol datë 04.01.2020 në të cilët përcaktohen punët që do të marrë secili prej operatorëve ekonomike pjesëmarrës në bashkim. Operatori ekonomik Alba Konstruksion midis të tjerave ka marrë përsipër të realizojë zërat e punimeve në kapitullin A11 të preventivit (punime fasade xhami të jashtme dhe të brëndshme ku përfshihen punimet e duraluminit. Në dokumentacionin e depozituar në sistemin elektronik të aplikimit nga operatori ekonomik Alba Konstruksion sh.p.k nuk rezulton të ketë paraqitur asnjë punonjës duralumin ashtu siç është kërkuar më sipër në kushtet e veçanta të kualifikimit. Vlen të theksohet se zërat e punimeve që kanë të bëjnë me punimet e duraluminit janë marrë përsipër të kryhen nga shoqëria Alba Konstruksion sh.p.k. Për sa më sipër Dokumentacioni i paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “Alba Konstruksion ”sh.p.k&4AM sh.p.k është i paplotë pasi nuk ka përmbushur kriteret e Veçanta të Kualifikimit/ Kapaciteti Teknik nuk zotëron kapacitet të mjaftueshem teknik për sa i përket stafit të pajisur me IQT për të realizuar kontratën për këtë objekt prokurimi duke mos përmbushur Kriteret e veçanta për kualifikim, Kapaciteti Teknik dhe profesional, , cka bie në kundërshtim me pikën 1 gërma (a) dhe (b) të nenit 46 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik” i ndryshuar ku përcaktohet se:

Operatorët ekonomik, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtëme që AK i vlerëson të nevojshme..... Pra sa më sipër cituar dokumentacioni i paraqitur nga Operatori Ekonomik lidhur me pikën 8 është i paplotë dhe për rrjedhojë i pavlefshëm.

Së katërti AK ka kërkuar në kriteret e veçanta të kualifikimit kapaciteti teknik pika 16 si më poshtë cituar: 16.Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratë (Shtojca 10).

Mjetet Sasia Gjendja Kamion vetëshkarkues (kapaciteti mbajtës minimum 5(pese) ton dhe maksimumi 10(dhjetë) ton për secilin kamion 8 copë Pronësi ose me qera Kamionçine (kapaciteti mbajtës minimum 1.5(nje pik pesë) ton dhe maksimumi 2(dy) ton për secilin kamionçinë 8 cope Pronësi ose me qera Në përmbushje të kriterit të kërkuar në DST nga Autoriteti Kontraktor pika 16 përkatësisht dëshmi mbi pajisjet teknike (përkatësisht mjetet me kapacitet mbajtës 5-10 ton sasia 8 copë) njëri nga pjesëtarët e bashkimit të operatorëve ekonomikë përkatësisht Alba Konstruksion sh.p.k ka deklaruar në shtojcën 10 se disponon 1(një) mjet kamion vetëshkarkues me targa TR5923S me kapacitet mbajtës 8,75 ton. Me qëllim realizimin e kontratës objekt prokurimi bashkimi i operatorëve ekonomikë “Alba Konstruksion” sh.p.k&”4 AM sh.p.k” kanë paraqitur në sistemin elektronik kontratën e bashkëpunimit nr.13 rep,nr.2 kol datë 04.01.2020 në të cilët përcaktohen përqindja e pjesëmarrjes dhe punët që do të marrë secili prej operatorëve ekonomike pjesëmarrës në bashkim. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave vëren se operatori ekonomik Alba Konstruksion sh.p.k ka marrë përsipër të kryejë 28,76% dhe 4 AM sh.p.k ka marrë përsipër të kryejë 71,24% të punimeve. Referuar përqindjes së marrë përsipër në kontratën e bashkëpunimit datë 04.01.2020 operatori ekonomik “Alba Konstruksion” sh.p.k duhej të paraqiste në sistemin elektronik të app-së 2 mjete(kamion vetëshkarkues) me kapacitet mbajtës 5-10 ton shoqëruar me dokumentacionin e kërkuar në DST. Pra , në bazë të përqindjes së marrë përsipër në kontratën e bashkëpunimit operatori ekonomik Alba Konstruksion sh.p.k duhej të dëshmonte se dispononte 2 mjete vetëshkarkues me kapacitet 5-10 ton për të realizuar kontratën objekt prokurimi. Gjithashtu në përmbushje të kriterit të kërkuar në DST nga Autoriteti Kontraktor pika 16 dëshmi mbi pajisjet teknike (përkatësisht mjetet me kapacitet mbajtës 1,5 ton -2 ton sasia 8 copë) njëri nga pjesëtarët e bashkimit të operatorëve ekonomikë përkatësisht Alba Konstruksion sh.p.k ka deklaruar në shtojcën 10 se disponon 2 mjete me targa: 1.Mjeti me targa TR5923S kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 1 ton. 2. Mjeti me targa AA169RP kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 1 ,85 ton mjet i cili do të konsiderohet i rregullt dhe do të futet në kategorinë e mjeteve 1,5- 2 ton. Referuar përqindjes së marrë përsipër në kontratën e bashkëpunimit operatori ekonomik Alba Konstruksion sh.p.k duhej të dëshmonte se disponon 2 mjete me kapacitet mbajtës min 1,5- max - 2 ton me tonazhin e kërkuar dhe dokumentacionin e kërkuar sipas DST. Sqarojmë se, referuar rregullave të prokurimit publik, përmbushja e kriterëve dhe kërkesave të autoritetit kontraktor duhet të bëhet nga secili anëtar i bashkimit në përputhje me përqindjen e punëve të marra përsipër. Qëllimi i shprehur qartësisht në nenin 74 pika 3 e VKM nr.914 datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, është që ndarja në përqindje e kontributit dhe në terma konkretë të punëve për secilin anëtar të bashkimit nëpërmjet aktmarrëveshjes bëhet pikërisht në funksion të përmbushjes së

kritereve në atë masë apo në proporcion me atë që operatori ekonomik ka marrë përsipër të kryejë për realizimin me sukses të kontratës. Për sa më sipër Dokumentacioni i paraqitur nga BO"Alba Konstruksion sh.p.k &"4 AM "sh.p.k është i paplotë pasi nuk ka përmbushur kriteret e Veçanta të Kualifikimit/ Kapaciteti Teknik për shkak se njëri nga operatorët ekonomikë Alba Konstruksion sh.p.k nuk zotëron kapacitet të mjaftueshem teknik për sa i përket numrit të mjeteve vetëshkarkues 5-10 ton si dhe mjetet me kapacitet min 1,5 ton- 2 ton për të realizuar kontratën për këtë objekt prokurimi duke mos përmbushur Kriteret e veçanta për kualifikim, Kapaciteti Teknik dhe profesional, , cka bie në kundërshtim me pikën 1 gërma (a) dhe (b) të nenit 46 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin Publik" i ndryshuar ku përcaktohet se:Operatorët ekonomik, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtëme që AK i vlerëson të nevojshme.....

Pra sa më sipër cituar dokumentacioni i paraqitur nga Operatori Ekonomik përkatësisht Alba Konstruksion sh.p.k lidhur me numrin e mjeteve vetëshkarkues me kapacitet mbajtës 5-10 ton dhe mjetet me kapacitet mbajtës min 1,5 ton dhe max 2 ton është i paplotë.

II.4. Në datën 22.01.2020, operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, ku kundërshton skualifikimin e ofertës së tij.

Konkretisht operatori ekonomik ankimues pretendon se:

Arsyeja e parë e skualifikimit është:

Së pari AK ka kërkuar në kriteret e veçanta të kualifikimit kapaciteti teknik pika 16 si më poshtë cituar:

16.Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratë (Shtojca 10). Mjetet Sasia Gjendja Kamion vetëshkarkues (kapaciteti mbajtës minimum 5(pese) ton dhe maksimumi 10(dhjetë) ton për secilin kamion 8 copë Pronësi ose me qera Kamion vetëshkarkues (kapaciteti mbajtës minimum 12(dymbëdhjetë) ton dhe maksimumi 17(shtatëmbëdhjetë) ton për secilin kamion 5 Cope Pronësi ose me qera Kamion vetëshkarkues (kapaciteti mbajtës minimum 25 ton 4 cope Pronësi ose me qera Eskavator me zinxhir 0.25 m3 2 Cope Pronësi ose me qera Eskavator me cekic 2 cope Pronësi ose me qera Kamionçinë (kapaciteti mbajtës minimum 1.5 (nje pik pesë) ton dhe maksimumi 2(dy) ton për secilin kamionçinë 8 cope Pronësi ose me qera Fadrome me goma 2 copë Pronësi ose me qera Eskavator me goma 0.25 m3 2 copë Pronësi ose me qera Sonde shpimi ø600mm deri ne 20m 1 cope Pronësi ose me qera Autobot uji 2 copë Pronësi ose me qera Automjet per mbjellje bari 1 cope Pronësi ose me qera Autobetoniere 4 copë Pronësi ose me qera Autopompe Betoni 2 cope Pronësi ose me qera Autovinc 3 cope Pronësi ose me qera Pompe suvatimi 2 cope Pronësi ose me qera Pompë Uji 2 cope Pronësi ose me qera Rrul ngjeshes deri ne 2 Ton 2 cope Pronësi ose me qera Makineri per shtresa betoni 1 cope Pronësi ose me qera Paisje per ngjitjen e tubave metalik 1 cope Pronësi ose me qera Bobcat 2 cope Pronësi ose me qera Minieskavator me zinxhir gome 2 cope Pronësi ose me qera Minifadrome 1 cope Pronësi ose me qera Vibrator 6 cope Pronësi ose me qera Matrapik 6 cope Pronësi ose me qera Trapan 4 cope Pronësi ose me qera Moto/gjenerator 3 cope Pronësi ose me qera Makine per ngjitje tubash HDPE

2 cope Pronësi ose me qera Saldatrice 4 cope Pronësi ose me qera Paisje per pastrim dhe lucidim pllakave dhe mermerit 1 cope Pronësi ose me qera Paisje ndricimi per kantier 1 cope Pronësi ose me qera Kompaktor ngjeshes 3 cope Pronësi ose me qera Kompresor ajri 3 cope Pronësi ose me qera Makineri CNC per prerjen te formave te crregullta 1 cope Pronësi ose me qera Bango per profilet e aluminit 1 cope Pronësi ose me qera Tranxhe 2 cope Pronësi ose me qera Kalander 2 cope Pronësi ose me qera Skela 2500 m2 Pronësi ose me qera Vinc Karrel 3 Cope Pronësi ose me qera UPS 200KVA 2 cope Pronësi ose me qera Zyrë kantieri e lëvizeshme 2 cope Pronësi ose me qera Nyje inerte dhe prodhim betoni 1 cope Pronësi ose me qera Te paraqiten mjete dhe pajisje të mbrojtjes në punë të punëtorëve, personelit si më poshtë: y) Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik, Çertifikatë për transport mallrash për llogari të vetë dhe siguracionin e mjetit (te vlefshme), dhe per mjetet e siguruara me qera, dokumenti qe verteton regjistrimin e tij plus certifikaten e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit,(te vlefshme) Çertifikatë për transport mallrash për të tretë dhe me qera brenda vendit, duhet te shoqerohet me kontraten perkatese te qerases/furnizimit, e vlefshme per te gjithë periudhen e realizimit te kontrates objekt i ketij prokurimi. Në rastin e mjeteve te tjera duhet te jene aktet e çdoganimit ose faturat tatimore te blerjes. z) Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre.

aa) Për mjetet e marra me qera të të paraqitet kontrata përkatëse noteriale e qirasë ku të specifikohet objekti i kontratës dhe afati i saj.

bb) Per fabriken e prodhimit te betonit, ne rast se eshte ne pronesi duhet te paraqitet akti i pronesise i shoqeruar me leje mjedisore leshuar nga QKL. Ne rast se operatori ekonomik ka kontrate qeraje duhet te paraqitet akti i pronesise se qiradhensit shoqeruar me lejen mjedisore leshuar nga QKL. Kontrata e qerases duhet te jete e noterizuar, ku të specifikohet objekti i kontratës dhe afati i saj. ç) Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.

dd) Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruara sipas shtojcës Nr. 10. (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese).

ee) Makineritë e mësipërme nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera dhe nuk janë te deklaruara ne procedurat te shpallura fitues nga autoriteti kontraktor, UKT sha. (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese ku te deklarohet dhe vendndodhja e mjeteve ne pronesi ose me qera me qellim verifikimi).

ff) (opsion) Do të organizohet një vizitë në kantier deri në date 16.12.2019 në mënyrë të tillë që Operatorët Ekonomikë të mund të familiarizohen me kushtet lokale. Operatori i interesuar Ekonomik duhet të konfirmojë paraprakisht me shkrim synimin e tij për të marrë pjesë në këtë vizitë. Gjatë vizitës do t'u jepen informacione shitesë e shpjegime. Të gjitha kostot e Operatorëve Ekonomikë që lidhen me vizitën në kantier duhet të mbulohen nga vetë ata. Pa paragjykuar sa më sipër, dhe me kostot e risqet e veta, një operator ekonomik mund t'a vizitojë në çdo kohë vendndodhjen e kantierit, nëse një gjë e tillë është e mundur. Për të organizuar një vizitë në kantier, ju lutem drejtoni nje shkrese prane Drejtorise se Prokurimit UKT sha.

Bashkimi i Operatoreve Ekonomik "4 AM" sh.p.k & "Alba Konstruksion" sh.p.k kanë deklaruar në shtojcën nr.10 se disponon mjetet e mëposhtme: Per te permbushur kriterin kamionçinë me kapacitet mbajtes min 1,5 ton- max 2 ton per secilin kamioncinë (8 cope) operatorët ekonomikë kanë paraqitur mjetet e mëposhtme: - Kamionçinë me targa AA367NS me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 2,26 ton paraqitur nga operatori ekonomik 4AM sh.p.k. - Kamionçinë me targa AA882PM me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 2,02 ton mjet i cili do të konsiderohet i rregullt dhe do të futet në kategorinë e mjeteve min 1,5 ton –max 2 ton. - Kamionçinë me targa AA053XC me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 1,4 ton paraqitur nga operatori ekonomik 4AM sh.p.k. - Kamionçinë me targa AA955RP me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 1,8 ton paraqitur nga operatori ekonomik 4AM siguruar nëpërmjet kontratës së qerasë Nr.10404/Rep,Nr.1659/1 Kol. - Kamionçinë me targa AA522JB me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 1,5 ton paraqitur nga operatori ekonomik 4AM siguruar nëpërmjet kontratës së qerasë Nr.10405/Rep,Nr.1660/1 Kol. - Kamionçinë me targa AA852OZ me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 1,61 ton paraqitur nga operatori ekonomik 4AM siguruar nëpërmjet kontratës së qerasë Nr.10406/Rep,Nr.1661/1 Kol. - Kamionçinë me targa TR7649P me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 1,52 ton paraqitur nga operatori ekonomik 4AM siguruar nëpërmjet kontratës së qerasë Nr.10406/Rep,Nr.1661/1 Kol. - Kamionçinë me targa AA233MN me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 1,52 ton paraqitur nga operatori ekonomik 4AM siguruar nëpërmjet kontratës së qerasë . - Kamionçinë me targa AA657JY me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 1,53 ton paraqitur nga operatori ekonomik 4AM mjet i cili do të konsiderohet i rregullt dhe do të futet në kategorinë e mjeteve min 1,5 ton-max 2 ton. - Mjeti me targa TR5800B me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 1 ton paraqitur nga operatori ekonomik Alba Konstruksion sh.p.k. - Kamionçinë me targa AA169RP me kapacitet me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 1,85 ton paraqitur nga operatori ekonomik Alba Konstruksion sh.p.k mjet i cili do të konsiderohet i rregullt dhe do të futet në kategorinë e mjeteve min 1,5 ton-max 2 ton. Komisioni i Vlerësimit të ofertave gjatë shqyrtimit të dokumentacionit në sistemin elektronik për mjetet me targa AA955RP,AA522JB,AA852OZ,TR7649P ,AA233MN (mjete të siguruara me kontrata qeraje nga operatori ekonomik 4 AM sh.p.k) vëren se në përmbushje të kushteve të veçanta të kualifikimit të kërkuar në DST operatori ekonomik ka paraqitur leje qarkullimi, çertifikatë e kontrollit teknik, ,taksë vjetore,foto të mjetit si dhe çertifikatë për transport mallrash për llogari të vet. Ajo çka konstaton Komisioni i Vlerësimit të Ofertave është se çertifikatat e lëshuara për mjetet e mësipërme nga njësia vendore për transport mallrash janë cilësuar "Për llogari të vet, pra qeradhënësi e ka për përdorim vetjak. Dhënia e tyre me qera është në kundërshtim me përcaktimet në nenin 81, pika 1,2,3,4,5 dhe 7,8 "Destinacioni dhe Përdorimi i Mjeteve" i ligjit nr.8378 datë 22.07.1998 "Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, në nenin 3, paragrafi 3.13 dhe 3.14 të Ligjit nr.8308, datë 18.3.1998 për "Transportet rrugore", si dhe në nenin 41, të Ligjit nr.8308, datë 18.3.1998 për "Transportet rrugore", ku parashikohet se: "Transporti i mallrave me qira dhe për të tretë është i ndaluar të kryhet pa licencën përkatëse. Sa më sipër cituar bashkimi

i operatoreve ekonomik nuk e përmbush kriterin e përcaktuar nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit për: - Paraqitjen e 8 mjeteve me kapacitet mbajtës min 1,5 ton dhe max 2 ton pasi nga 8 mjete të kërkuara nga AK kanë paraqitur vetëm 3 mjete të sakta sipas tonazhit dhe dokumentacionit të kërkuar. Për të përmbushur kriterin me kapacitet mbajtës min 5 ton- max 10 ton për secilin kamion vetëshkarkues (8 cope) operatorët ekonomikë kanë paraqitur mjetet e mëposhtme: - Mjeti me targa AA465 PC me kapacitet mbajtës cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 11,2 ton. - Mjeti me targa AA469PC me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 4,9 ton. - Mjeti me targa AA718VL me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 9,3 ton mjet i cili do të konsiderohet i rregullt dhe do të futet në kategorinë e mjeteve min 5 ton-max 10 ton. - Kamion vetëshkarkues TR3878K me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 7,76 ton mjet i cili do të konsiderohet i rregullt dhe do të futet në kategorinë e mjeteve min 5 ton-max 10 ton. - Kamion vetëshkarkues TR3717P me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 8,2 ton mjet i cili do të konsiderohet i rregullt dhe do të futet në kategorinë e mjeteve min 5 ton-max 10 ton. - Kamion vetëshkarkues AA025RK me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 10,03 ton mjet i cili do të konsiderohet i rregullt dhe do të futet në kategorinë e mjeteve min 5 ton-max 10 ton. - Kamion vetëshkarkues AA106MR me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 8,7 ton mjet i siguruar nëpërmjet kontratës së qerasë nga operatori ekonomik 4 AM sh.p.k. - Kamion vetëshkarkues AA908 me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 7,6 ton mjet i siguruar nëpërmjet kontratës së qerasë nga operatori ekonomik 4 AM sh.p.k. - Kamion vetëshkarkues AA853ND me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 8,95 ton mjet i cili do të konsiderohet i rregullt dhe do të futet në kategorinë e mjeteve me kapacitet min 5 ton- max 10 ton. - Kamion vetëshkarkues TR0715T me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 9,24 ton mjet i cili do të konsiderohet i rregullt dhe do të futet në kategorinë e mjeteve me kapacitet min 5 ton- max 10 ton. - Kamion vetëshkarkues TR5923S me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 8,75 ton paraqitur nga operatori ekonomik Alba Konstruksion sh.p.k mjet i cili do të konsiderohet i rregullt dhe do të futet në kategorinë e mjeteve me kapacitet min 5 ton- max 10 ton. Komisioni i Vlerësimit të ofertave gjatë shqyrtimit të dokumentacionit në sistemin elektronik për mjetet me targa AA106MR, AA908 mjete të siguruara me kontrata qeraje nga operatori ekonomik 4 AM sh.p.k) vëren se në përmbushje të kushteve të veçanta të kualifikimit të kërkuar në DST operatori ekonomik ka paraqitur leje qarkullimi, çertifikatë e kontrollit teknik, ,taksë vjetore,foto të mjetit si dhe çertifikatë për transport mallrash për llogari të vet. Ajo çka konstaton Komisioni i Vlerësimit të Ofertave është se çertifikatat e lëshuara për mjetet e mësipërme nga njësia vendore për transport mallrash janë cilësuar “Për llogari të vet, pra qeradhënësi e ka për përdorim vetjak. Dhënia e tyre me qera është në kundërshtim me përcaktimet në nenin 81, pika 1,2,3,4,5 dhe 7,8 “Destinacioni dhe Përdorimi i Mjeteve” i ligjit nr.8378 datë 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, në nenin 3, paragrafi 3.13 dhe 3.14 të Ligjit nr.8308, datë 18.3.1998 për “Transportet rrugore”, si dhe në nenin 41, të Ligjit nr.8308, datë 18.3.1998 për “Transportet rrugore”, ku parashikohet se: “Transporti i mallrave me qira dhe për të tretë është i ndaluar të kryhet pa licencën përkatëse. Sa më sipër cituar bashkimi i operatoreve ekonomik nuk

e përmbush kriterin e përcaktuar nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit për: Paraqitjen e 8 mjeteve me kapacitet mbajtës min 5 ton dhe max 10 ton pasi nga 8 mjete të kërkuara nga AK kanë paraqitur vetëm 7 mjete të sakta sipas tonazhit dhe dokumentacionit të kërkuar në DST. Për sa më sipër Dokumentacioni i paraqitur nga .BO"Alba Konstruksion sh.p.k &"4 AM "sh.p.k është i paplotë pasi nuk ka përmbushur kriteret e Veçanta të Kualifikimit/ Kapaciteti Teknik nuk zotëron kapacitet të mjaftueshem teknik për sa i përket mjeteve për të realizuar kontratën për këtë objekt prokurimi duke mos përmbushur Kriteret e veçanta për kualifikim, Kapaciteti Teknik dhe profesional, , cka bie në kundërshtim me pikën 1 gërma (a) dhe (b) të nenit 46 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin Publik" i ndryshuar ku përcaktohet se: Operatorët ekonomik, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtëme që AK i vlerëson të nevojshme.....

Pra sa më sipër cituar dokumentacioni i paraqitur nga Operatori Ekonomik lidhur me shtojcën 10, është i paplotë.

AK pretendon se dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik lidhur me shtojcën 10 është i paplotë.

Në përmbushje të kërkesës së mësipërme bashkimi i operatorëve ekonomikë ka paraqitur këto kamioncina:

Shoqëria 4 AM

AA 367 NS 2.26 ton (në pronësi)

AA 882 PM 2.02 ton (në pronësi)

AA 053 XC 1.4 ton (në pronësi)

AA 955 RP 1.8 ton (me qera)

AA 522 JB 1.5 ton (me qera)

AA 852 OZ 1.61 ton (me qera)

TR 7649 P 1.52 ton (me qera)

AA 233 MN 1.52 ton (me qera)

AA 657 JY 1.53 ton (me qera)

Shoqëria Alba Konstruksion

AA 169 RP 1.85 ton (në pronësi)

Në përmbushje të kërkesës së mësipërme bashkimi i operatorëve ekonomikë ka paraqitur këto kamiona:

Shoqëria 4 AM

Kamion TR 3878 K 7.76 ton (me qera)

Kamion TR 3717 P 8.2 ton (me qera)

Kamion AA 025 RK 9.97 ton (me qera)

Kamion AA 106 MR 8.7 ton (me qera)

Kamion AA 908 MB 7.6 ton (me qera)

Kamion AA 946 HP 9.5 ton (me qera)

Kamion AA 853 ND 9 ton (me qera)

Kamion TR 0715 T 9.24 ton (me qera)

Shoqëria Alba Konstruksion

Kamion TR 5923 S 8.75 ton (në pronësi)

Dokumentacioni i paraqitur për këto mjete është plotësisht sipas kërkesave për kualifikim (dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), certifikata e kontrollit teknik, certifikata për transport mallrash dhe siguracioni i mjetit (të vlefshme).

Secili mjet i paraqitur më sispër i ka pasur dokumentat e kërkuara. Përsa i përket pretendimit se certifikatat për transport mallrash për mjetet me qera është për llogari të vet dhe jo për të tretë theksojmë se:

Së pari: shoqëria 4 AM (e cila ka përqindjen më të madhe dhe njëkohësisht edhe kapacitetet më të shumta) është e licencuar për transport mallrash për të tretë me qera në transportin kombëtar dhe ndërkombëtar (licenca bashkëlidhur).

Së dyti: Në rast se do të fitohet kjo procedurë, BOE do ti marrë të gjitha certifikimet përkatëse (përfshirë këtu edhe certifikatat për transport mallrash për të tretë për mjetet e marra me qera) për të zbatuar kontratën me përpikmëri dhe konform legjislacionit në fuqi pasi duke qenë kontratë me objekt të veçantë (me objektin e procedurës së tenderit) këto mjete do të merren me qera vetëm nëse bashkimi i operatorëve ekonomikë shpallet fitues. Theksojmë se çdo mjet është i certifikuar, i pajisur me dokumentacion të plotë për të vërtetuar se këto kapacitete përmbushen nga BOE.

Kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë të cilët nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se gëzojnë të gjitha kapacitetet në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Për autoritetin kontraktor është e rëndësishme që nga dokumentacioni i paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë të vërtetohet se gëzon dhe disponon kapacitetet e duhura në lidhje me mjetet për realizimin me sukses të kontratës fakt ky i vërtetuar nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur aq më tepër në kushtet kur ky dokumentacion (kontrata e qerasë) është lidhur me shprehje të vullnetit të lirë të dy palëve nënshkrues të kontratës e për më tej duke u dhënë të gjitha garancitë e kërkuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit pasi në këtë kontratë përmbahen të dhëna të mjaftueshme për të arritur qëllimin për të cilin autoriteti kontraktor e ka kërkuar këtë kriter duke siguruar një panoramë të plotë në lidhje me mjetet dhe pajisjet. Sqarojmë se për autoritetin kontraktor është e domosdoshme që një operator ekonomik pjesëmarrës të përmbushë kriteret e përcaktuara nga ai në dokumentat e tenderit duke vërtetuar se disponon kapacitetet ekonomike, financiare, teknike profesionale me dokumentacionin e paraqitur në tërësi dhe në kompleksitet.

Pretendimi i autoritetit kontraktor për mospërmbushje të këtij kriteri nuk qëndron. Ky kriter është plotësuar dhe tejkaluar.

Arsyeja e dytë e skualifikimit është;

Së dyti AK ka kërkuar në pikën 8 të kushteve të veçanta të kualifikimit si më poshtë cituar: 7.Të ketë në stafin e punonjesve te pasqyruar ne list pagesat e shoqërisë për te pakten 2 muajt e fundit të pakten 60 (gjashtëdhjetë) punonjës të pajisur me deshmi kualifikimi te sigurimit teknik nga ISHTI ose nga institucione ekuivalente me të si më poshtë: - teknike ndertimi 2 Kategoria II - karpentier 5 Kategoria I - hekurkthyes 4 Kategoria I - murator/suvatues 10 Kategoria I - pllakashtrues 8 Kategoria I - elektrikist 11 3 Punonjës Kategoria IV dhe 8 Punonjës Kategoria III

- hidraulik 6 *Kategoria II* - bojaxhi 7 *Kategoria I* - punetor duroalumini 5 *Kategoria I* - montator 2 *Kategoria II* (Per punonjesit e siperpermendur te paraqiten deshmitë perkatëse te kualifikimit te sigurimit teknik, kontratat e punes te vlefshme) Bashkimi i operatorëve ekonomikë kanë nënshkruar marrëveshjen e bashkëpunimit nr.13 rep dhe 2 kol datë 04.01.2020 në të cilët përcaktohen punët që do të marrë secili prej operatorëve ekonomike pjesëmarrës në bashkim. Operatori ekonomik Alba Konstruksion midis të tjerave ka marrë përsipër të realizojë zërat e punimeve në kapitullin A11 të preventivit (punime fasade xhami të jashtme dhe të brëndshme ku përfshihen punimet e duraluminit. Në dokumentacionin e depozituar në sistemin elektronik të aplikuar nga operatori ekonomik Alba Konstruksion sh.p.k nuk rezulton të ketë paraqitur asnjë punonjës duralumin ashtu siç është kërkuar më sipër në kushtet e veçanta të kualifikimit. Vlen të theksohet se zërat e punimeve që kanë të bëjnë me punimet e duraluminit janë marrë përsipër të kryhen nga shoqëria Alba Konstruksion sh.p.k. Për sa më sipër Dokumentacioni i paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “Alba Konstruksion ”sh.p.k&4AM sh.p.k është i paplotë pasi nuk ka përmbushur kriteret e Veçanta të Kualifikimit/ Kapaciteti Teknik nuk zotëron kapacitet të mjaftueshem teknik për sa i përket stafit të pajisur me IQT për të realizuar kontratën për këtë objekt prokurimi duke mos përmbushur Kriteret e veçanta për kualifikim, Kapaciteti Teknik dhe profesional, , cka bie në kundërshtim me pikën 1 gërma (a) dhe (b) të nenit 46 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik” i ndryshuar ku përcaktohet se: Operatorët ekonomik, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtëme që AK i vlerëson të nevojshme..... Pra sa më sipër cituar dokumentacioni i paraqitur nga Operatori Ekonomik lidhur me pikën 8 është i paplotë dhe për rrjedhojë i pavlefshëm.

AK pretendon se dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik lidhur me pikën 8 është i paplotë dhe për rrjedhojë i pavlefshëm.

Në kriteret kërkohet:

8. Të ketë në stafin e punonjesve te pasqyruar ne list pagesat e shoqërisë për te pakten 2 muajt e fundit të pakten 60 (gjashtëdhjetë) punonjës të pajisur me deshmi kualifikimi te sigurimit teknik nga ISHTI ose nga institucione ekuivalente me të si më poshtë:

- | | |
|-------------------------|--|
| - teknike ndertimi 2 | <i>Kategoria II</i> |
| - karpentier 5 | <i>Kategoria I</i> |
| - hekurkthyes 4 | <i>Kategoria I</i> |
| - murator/suvatues 10 | <i>Kategoria I</i> |
| - pllakashtrues 8 | <i>Kategoria I</i> |
| - elektrikist 11 | 3 Punonjës <i>Kategoria IV</i> dhe 8 Punonjës <i>Kategoria III</i> |
| - hidraulik 6 | <i>Kategoria II</i> |
| - bojaxhi 7 | <i>Kategoria I</i> |
| - punetor duroalumini 5 | <i>Kategoria I</i> |
| - montator 2 | <i>Kategoria II</i> |

(Per punonjesit e siperpermendur te paraqiten deshmitë perkatëse te kualifikimit te sigurimit teknik, kontratat e punes te vlefshme)

Bashkimi i operatorëve ekonomikë sëbashku i ka plotësuar të gjitha kërkesat e mësipërme. Dokumentacioni i paraqitur për specialistët e mësipërm është i plotë (i pranuar edhe nga AK). Referuar kontratës së bashkëpunimit nr. 13 rep dhe nr. 2 kol datë 04.01.2020 shoqëria Alba Konstruksion dhe 4 A-M citohet: “Shoqëria 4 A – M” sh.p.k. dhe shoqëria “Alba Konstruksion” sh.p.k. bashkojnë kapitalet, makineritë, fuqinë punëtore, bilancet e tyre e të tjera dhe janë përgjegjëse solidare për punimet e kryera, detyrimet kontraktuale dhe në mënyrë të veçantë për zbatimin e kushteve të kontratës dhe të grafikut të punimeve”.

Palët bien dakord që të themelojnë në rolin e kordinatorit të këtij grupi një staf indipendent, detyrat e përgjegjësitë e të cilët do të përcaktohen në një kontratë të detajuar në rastin e shpalljes fitues të këtij grupi”.

Të gjitha këto plotësohen në total nga i gjithë bashkimi i operatorëve ekonomikë.

Kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë të cilët nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se gëzojnë të gjitha kapacitetet në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Në këtë kuptim autoriteti kontraktor duhet të gjykojë në kompleksitet dokumentacionin dhe të analizojë në themel kapacitetet e ofertuesit në funksion të qëllimit dhe rrethanae faktike për të cilat vendosen kriteret e përcaktuara.

Pretendimi i autoritetit kontraktor për mospërmbushje të këtij kriteri nuk qëndron.

Pra BOE nëpërmjet kualifikimeve që ajo disponon, dokumentacionit të paraqitur në tender vërteton kapacitetin dhe mundësinë e përmbushjes së kontratës me korrektësi dhe konform legjislacionit në fuqi.

Arsyeja e trete e skualifikimit është:

Së treti AK ka kërkuar në kriteret e veçanta të kualifikimit kapaciteti teknik pika 16 si më poshtë cituar: 16.Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratë (Shtojca 10).

Mjetet Sasia Gjendja Kamion vetëshkarkues (kapaciteti mbajtës minimum 5(pese) ton dhe maksimumi 10(dhjetë) ton për secilin kamion 8 copë Pronësi ose me qera Kamionçine (kapaciteti mbajtës minimum 1.5(nje pik pesë) ton dhe maksimumi 2(dy) ton për secilin kamionçinë 8 cope Pronësi ose me qera Në përmbushje të kriterit të kërkuar në DST nga Autoriteti Kontraktor pika 16 përkatësisht dëshmi mbi pajisjet teknike (përkatësisht mjetet me kapacitet mbajtës 5-10 ton sasia 8 copë) njëri nga pjesëtarët e bashkimit të operatorëve ekonomikë përkatësisht Alba Konstruksion sh.p.k ka deklaruar në shtojcën 10 se disponon 1(një) mjet kamion vetëshkarkues me targa TR5923S me kapacitet mbajtes 8,75 ton. Me qëllim realizimin e kontratës objekt prokurimi bashkimi i operatorëve ekonomikë “Alba Konstruksion” sh.p.k&”4 AM sh.p.k” kanë paraqitur në sistemin elektronik kontratën e bashkëpunimit nr.13 rep,nr.2 kol datë 04.01.2020 në të cilët përcaktohen përqindja e pjesëmarrjes dhe punët që do të marrë secili prej operatorëve ekonomike pjesëmarrës në bashkim. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave vëren se operatori ekonomik Alba Konstruksion sh.p.k ka marrë përsipër të kryejë 28,76% dhe 4 AM sh.p.k ka marrë përsipër të kryejë 71,24% të punimeve. Referuar përqindjes së marrë përsipër në kontratën e bashkëpunimit

datë 04.01.2020 operatori ekonomik “Alba Konstruksion” sh.p.k duhej të paraqiste në sistemin elektronik të app-së 2 mjete(kamion vetëshkarkues) me kapacitet mbajtës 5-10 ton shoqëruar me dokumentacionin e kërkuar në DST. Pra , në bazë të përqindjes së marrë përsipër në kontratën e bashkëpunimit operatori ekonomik Alba Konstruksion sh.p.k duhej të dëshmonte se dispononte 2 mjete vetëshkarkues me kapacitet 5-10 ton për të realizuar kontratën objekt prokurimi. Gjithashtu në përmbushje të kriterit të kërkuar në DST nga Autoriteti Kontraktor pika 16 dëshmi mbi pajisjet teknike (përkatësisht mjetet me kapacitet mbajtës 1,5 ton -2 ton sasia 8 copë) njëri nga pjesëtarët e bashkimit të operatorëve ekonomikë përkatësisht Alba Konstruksion sh.p.k ka deklaruar në shtojcën 10 se disponon 2 mjete me targa: 1.Mjeti me targa TR5923S kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 1 ton. 2. Mjeti me targa AA169RP kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 1,85 ton mjet i cili do të konsiderohet i rregullt dhe do të futet në kategorinë e mjeteve 1,5- 2 ton. Referuar përqindjes së marrë përsipër në kontratën e bashkëpunimit operatori ekonomik Alba Konstruksion sh.p.k duhej të dëshmonte se disponon 2 mjete me kapacitet mbajtës min 1,5- max - 2 ton me tonazhin e kërkuar dhe dokumentacionin e kërkuar sipas DST. Sqarojmë se, referuar rregullave të prokurimit publik, përmbushja e kriterëve dhe kërkesave të autoritetit kontraktor duhet të bëhet nga secili anëtar i bashkimit në përputhje me përqindjen e punëve të marra përsipër. Qëllimi i shprehur qartësisht në nenin 74 pika 3 e VKM nr.914 datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, është që ndarja në përqindje e kontributit dhe në terma konkretë të punëve për secilin anëtar të bashkimit nëpërmjet aktmarrëveshjes bëhet pikërisht në funksion të përmbushjes së kriterëve në atë masë apo në proporcion me atë që operatori ekonomik ka marrë përsipër të kryejë për realizimin me sukses të kontratës. Për sa më sipër Dokumentacioni i paraqitur nga BO”Alba Konstruksion sh.p.k &”4 AM ”sh.p.k është i paplotë pasi nuk ka përmbushur kriteret e Veçanta të Kualifikimit/ Kapaciteti Teknik për shkak se njëri nga operatorët ekonomikë Alba Konstruksion sh.p.k nuk zotëron kapacitet të mjaftueshem teknik për sa i përket numrit të mjeteve vetëshkarkues 5-10 ton si dhe mjetet me kapacitet min 1,5 ton- 2 ton për të realizuar kontratën për këtë objekt prokurimi duke mos përmbushur Kriteret e veçanta për kualifikim, Kapaciteti Teknik dhe profesional, , cka bie në kundërshtim me pikën 1 gërma (a) dhe (b) të nenit 46 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik” i ndryshuar ku përcaktohet se:Operatorët ekonomik, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtëme që AK i vlerëson të nevojshme.....

Pra sa më sipër cituar dokumentacioni i paraqitur nga Operatori Ekonomik përkatësisht Alba Konstruksion sh.p.k lidhur me numrin e mjeteve vetëshkarkues me kapacitet mbajtës 5-10 ton dhe mjetet me kapacitet mbajtës min 1,5 ton dhe max 2 ton është i paplotë.

AK pretendon se dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik Alba Konstruksion lidhur me numrin e mjeteve vetëshkarkues me kapacitet mbajtës 5-10 ton dhe mjetet me kapacitet mbajtës min 1.5 ton dhe max 2 ton është i paplotë.

Referuar kontratës së bashkëpunimit nr. 13 rep dhe nr. 2 kol datë 04.01.2020 shoqëritë Alba Konstruksion dhe 4 A-M citohet: “Shoqëria 4 A-M” sh.p.k. dhe shoqëria “Alba Konstruksion” sh.p.k. bashkëjnë kapitalet, makineritë, fuqinë punëtore, bilancet e tyre e të tjera dhe janë përgjegjëse solidare për punimet e kryera, detyrimet kontraktuale dhe në mënyrë të veçantë për zbatimin e kushteve të kontratës dhe të grafikut të punimeve”.

Palët bien dakord që të themelojnë në rolin e kordinatorit të këtij grupi një staf independent, detyrat e përgjegjësitë e të cilët do të përcaktohen në një kontratë të detajuar në rastin e shpalljes fitues të këtij grupi”.

Të gjitha kërkesat plotësohen në total nga bashkimi i operatorëve ekonomikë.

Kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë të cilët nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se gëzojnë të gjitha kapacitetet në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Në këtë kuptim autoriteti kontraktor duhet të gjykojë në kompleksitet dokumentacionin dhe të analizojë në themel kapacitetet e ofertuesit në funksion të qëllimit dhe rrethanae faktike për të cilat vendosen kriteret e përcaktuara.

Pretendimi i autoritetit kontraktor për mospërbushje të këtij kriteri nuk qëndron.

Pra BOE nëpërmjet kualifikimeve që ajo disponon, dokumentacionit të paraqitur në tender vërteton kapacitetin dhe mundësinë e përbushjes së kontratës me korrektësi dhe konform legjislacionit në fuqi.

Pretendimi i autoritetit kontraktor për mospërbushje të këtij kriteri nuk qëndron.

Pra BOE nëpërmjet kualifikimeve që ajo disponon, dokumentacionit të paraqitur në tender vërteton kapacitetin dhe mundësinë e përbushjes së kontratës me korrektësi dhe konform legjislacionit në fuqi.

Arsyeja e katërt e skualifikimit është:

Së katërti AK ka kërkuar në kushtet e veçanta të kualifikimit si më poshtë cituar: 17. Ofertuesi duhet të paraqesë autorizim nga prodhuesi/ distributori i autorizuar nga prodhuesi me të cilin prodhuesi / distributori i autorizuar, autorizon ofertuesin të ofertojë këto mallra në këtë procedurë prokurimi. Autorozimi duhet te permbaje te dhena te plota te prodhuesit si: Tel/fax/email. Ofertuesi te paraqese, kataloge ose fragmente te katalogut te prodhuesit per listen e materialeve te meposhtme qe do te ofroje ku te paraqiten te dhenat teknike baze. 1. Bojra 2. Pllakat 3. Paisjet elektrike 4. Kamerat 5. Sistemin e kondicionimit 6. Ndricimi Në përbushje të kriterëve të kërkuar në DST Komisioni i Vlerësimit të Ofertave vëren se një ndër pjesëtarët ekonomik përkatësisht “4AM”ka paraqitur në sistemin elektronik autorizim distributori për pajisjet elektrike nga Abbi-Esse,për pajisjet ndriçimi autorizim distributori nga Sali Elektrik,për pllakat autorizim distributor nga Delta sh.p.k ,për kamerat autorizim distributor Security Solution &Distribution ,për sistemin e kondicionimit autorizim distributori nga Superior Klima,për mallrat bojra autorizim prodhuesi lëshuar nga Deutchcolor. Në kontratën e bashkëpunimit nr.13 rep dhe 2 kol datë 04.01.2020 me anë të cilës është krijuar bashkimi i operatorëve ekonomikë përcaktohen qartë punët që do të marrë secili prej operatorëve ekonomike pjesëmarrës në bashkim. Operatori ekonomik Alba Konstruktion midis të tjerave ka marrë përsipër të realizojë zërat e punimeve në kapitullin A7 të preventivit objekt prokurimi (punime bojatisje në të cilën përfshihen lyerje tavane me bojë hidroplastike, lyerje mure të brëndshme me bojë hidroplastike).

Në dokumentacionin e depozituar në sistemin elektronik të app-së nga operatori ekonomik Alba Konstruksion sh.p.k nuk rezulton të ketë paraqitur asnjë autorizim prodhuesi apo distributori për mallrat bojra. Vlen të theksohet se zërat e punimeve që kanë të bëjnë me punimet e bojatisjes janë marrë përsipër të kryhen nga shoqëria Alba Konstruksion sh.p.k dhe për rrjedhojë operatori ekonomik Alba Konstruksion sh.p.k duhej të paraqiste në sistemin elektronik autorizim prodhuesi apo distributori për mallrat bojra. Theksojmë se kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë dhe përvojën e duhur, për të zbatuar kontratën objekt prokurimi, si edhe janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit, në mënyrë që edhe vlerësimi të bëhet në përputhje me këtë dokumentacion, pasi ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme, në mbështetje edhe të pikës 3, të nenit 66 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, në të cilën përcaktohet se komisioni verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentat e tenderit. Në shtojcën 12 të DST shprehimisht parashikohet seRastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim. Pra, sa më sipër cituar dokumentacioni i paraqitur nga Operatori Ekonomik lidhur me pikën 17 është i paplotë dhe për rrjedhojë i pavlefshëm. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të pikës 5, të nenit 53, të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për “Prokurimin publik”, i ndryshuar dhe mbështetje të Kreu VII, neni 66, pika 3, të VKM nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e shpall të pavlefshme këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në DST.

AK pretendon se operatori Alba Konstruksion nuk rezulton të ketë paraqitur asnjë autorizim prodhuesi apo distributori për mallrat bojëra.

Referuar kontratës së bashkëpunimit nr. 13 rep dhe nr. 2 kol datë 04.01.2020 shoqëritë Alba Konstruksion dhe 4 A-M citohet: “Shoqëria 4 A-M” sh.p.k. dhe shoqëria “Alba Konstruksion” sh.p.k. bashkojnë kapitalet, makineritë, fuqinë punëtore, bilancet e tyre e të tjera dhe janë përgjegjëse solidare për punimet e kryera, detyrimet kontraktuale dhe në mënyrë të veçantë për zbatimin e kushteve të kontratës dhe të grafikut të punimeve”.

Palët bien dakord që të themelojnë në rolin e kordinatorit të këtij grupi një staf independent, detyrat e përgjegjësitë e të cilit do të përcaktohen në një kontratë të detajuar në rastin e shpalljes fitues të këtij grupi”.

Të gjitha kërkesat plotësohen në total nga bashkimi i operatorëve ekonomikë.

Përsa i përket autorizimeve për furnizimin e materialeve, të cilat janë paraqitur në emër të shoqërisë “4 A-M” sh.p.k. kjo gjë nuk do të thotë që shoqëria Alba Konstruksion nuk ka kapacitetin për të kryer punime me materialet e autorizuara. Furnizimi i materialeve që disponojnë autorizim prodhuesi apo distributori mund të bëhet nëpërmjet kompanisë “4 A-M” sh.p.k.

Disponimi i autorizimeve të prodhuesve apo distributorëve dëshmon aftësinë e këtyre të fundit për furnizuar Bashkimin e operatorëve ekonomikë me materialet e kërkuara pa krijuar vonesa apo mangësi në sasi apo cilësi.

Besueshmëria dhe eksperiencia e kompanisë tregohet me anë të eksperiencave të ngjashme të paraqitura.

Kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë të cilët nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se gëzojnë të gjitha kapacitetet në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Në këtë kuptim autoriteti kontraktor duhet të gjykojë në kompleksitet dokumentacionin dhe të analizojë në themel kapacitetet e ofertuesit në funksion të qëllimit dhe rrethanae faktike për të cilat vendosen kriteret e përcaktuara.

Për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik zotëron kapacitetin teknik të mjaftueshëm për zbatimin e kontratës sikurse përcaktuar në nenin 46 të LPP i cili shpreh [...].

Pretendimi i autoritetit kontraktor për mospërbushje të këtij kriteri nuk qëndron.

Pra BOE nëpërmjet kualifikimeve që ajo disponon, dokumentacionit të paraqitur në tender vërteton kapacitetin dhe mundësinë e përmbushjes së kontratës me korrektësi dhe konform legjislacionit në fuqi.

Si përfundim kërkojmë marrjen parasysh të ankesës sonë dhe kualifikimin e ofertës së bashkimit të operatorëve ekonomikë “Alba Konstruksion” sh.p.k. & “4 A-M” sh.p.k.

II.5. Në datën 27.01.2020, me shkresën nr. 1881/1 Prot., autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje operatorit ekonomik ankimues, duke mos e pranuar ankesën e paraqitur nga ky i fundit.

II.6. Në datën 03.02.2020, operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë në Komisionin e Prokurimit Publik, duke kundërshtuar skualifikimin e tij.

Konkretisht në ankesën e paraqitur pranë KPP-së operatori ekonomik ankimues argumenton duke ngritur të njëjtat pretendime si edhe në ankesën e paraqitur pranë autoritetit kontraktor.

Në lidhje me kthimin e përgjigjes nga autoriteti kontraktor për arsyen e parë të skualifikimit, operatori ekonomik ankimues argumenton se:

[...]

Përsa i përket pretendimit të autoritetit kontraktor në kthimin e përgjigjes së ankesës se JV nuk mund të paraqesë dokumentacion të ri vlen theksohet se paraqitja e certifikatës për transport mallrash për të tretë dhe me qera e shoqërisë 4 A-M nuk ka për qëllim të dorëzojë një dokument të ri shtesë në këtë fazë, pasi ai është marrë para zhvillimit të procedurës dhe gjithashtu është një dokument shoqërues i cili mbështet argumentimin e JV në ankesë.

II.7. Në datën 17.02.2020, nëpërmjet shkresës me nr. K-407/1 prot., datë 14.02.2020, me objekt: “Informacion i hollësishëm mbi zhvillimin e procedurës së prokurimit me objekt “Ndërtimi i Godinës së Re të Ujësjetës”, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me ankesën e operatorit ekonomik ankimes.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumentave të dërguara nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimes se arsyeja e skualifikimit “Së pari AK ka kërkuar në kriteret e veçanta të kualifikimit kapaciteti teknik pika 16 si më poshtë cituar: 16.Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratë (Shtojca 10). Mjetet Sasia Gjendja Kamion vetëshkarkues (kapaciteti mbajtës minimum 5(pese) ton dhe maksimumi 10(dhjetë) ton për secilin kamion 8 copë Pronësi ose me qera Kamion vetëshkarkues (kapaciteti mbajtës minimum 12(dymbedhjetë) ton dhe maksimumi 17(shtatembedhjetë) ton për secilin kamion 5 Cope Pronësi ose me qera Kamion vetëshkarkues (kapaciteti mbajtës minimum 25 ton 4 cope Pronësi ose me qera Eskavator me zinxhir 0.25 m3 2 Cope Pronësi ose me qera Eskavator me cekic 2 cope Pronësi ose me qera Kamionçine (kapaciteti mbajtës minimum 1.5 (nje pik pesë) ton dhe maksimumi 2(dy) ton për secilin kamionçinë 8 cope Pronësi ose me qera Fadrome me goma 2 copë Pronësi ose me qera Eskavator me goma 0.25 m3 2 copë Pronësi ose me qera Sonde shpimi ø600mm deri ne 20m 1 cope Pronësi ose me qera Autobot uji 2 copë Pronësi ose me qera Automjet per mbjellje bari 1 cope Pronësi ose me qera Autobetoniere 4 copë Pronësi ose me qera Autopompe Betoni 2 cope Pronësi ose me qera Autovinc 3 cope Pronësi ose me qera Pompe suvatimi 2 cope Pronësi ose me qera Pompë Uji 2 cope Pronësi ose me qera Rrul ngjeshes deri ne 2 Ton 2 cope Pronësi ose me qera Makineri per shtresa betoni 1 cope Pronësi ose me qera Paisje per ngjitjen e tubave metalik 1 cope Pronësi ose me qera Bobcat 2 cope Pronësi ose me qera Minieskavator me zinxhir gome 2 cope Pronësi ose me qera Minifadrome 1 cope Pronësi ose me qera Vibrator 6 cope Pronësi ose me qera Matrapik 6 cope Pronësi ose me qera Trapan 4 cope Pronësi ose me qera Moto/gjenerator 3 cope Pronësi ose me qera Makine per ngjitje tubash HDPE 2 cope Pronësi ose me qera Saldatrice 4 cope Pronësi ose me qera Paisje per pastrim dhe lucidim pllakave dhe mermerit 1 cope Pronësi ose me qera Paisje ndricimi per kantier 1 cope Pronësi ose me qera Kompaktor ngjeshes 3 cope Pronësi ose me qera Kompresor ajri 3 cope Pronësi ose me qera Makineri CNC per prerjen te formave te crregullta 1 cope Pronësi ose me qera Bango per profilet e aluminit 1 cope Pronësi ose me qera Tranxhe 2 cope Pronësi ose me qera Kalandër 2 cope Pronësi ose me qera Skela 2500 m2 Pronësi ose me qera Vinc Karrel 3 Cope Pronësi ose me

qera UPS 200KVA 2 cope Pronësi ose me qera Zyrë kantieri e lëvizeshme 2 cope Pronësi ose me qera Nyje inerte dhe prodhim betoni 1 cope Pronësi ose me qera Te paraqiten mjete dhe pajisje të mbrojtjes në punë të punëtorëve, personelit si më poshtë: y) Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik, Çertifikatë për transport mallrash për llogari të vetë dhe siguracionin e mjetit (te vlefshme), dhe për mjetet e siguruar me qera, dokumenti që verteton regjistrimin e tij plus certifikaten e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit,(te vlefshme) Çertifikatë për transport mallrash për të tretë dhe me qera brenda vendit, duhet të shoqerohet me kontraten perkatese të qerases/furnizimit, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi. Në rastin e mjeteve të tjera duhet të jenë aktet e çdoganimit ose faturat tatimore të blerjes. z) Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre.

aa) Për mjetet e marra me qera të të paraqitet kontrata përkatëse noteriale e qirasë ku të specifikohet objekti i kontratës dhe afati i saj.

bb) Për fabrikën e prodhimit të betonit, në rast se është në pronësi duhet të paraqitet akti i pronësisë i shoqeruar me leje mjedisore leshuar nga QKL. Në rast se operatori ekonomik ka kontratë qeraje duhet të paraqitet akti i pronësisë së qiradhensit shoqeruar me lejen mjedisore leshuar nga QKL. Kontrata e qerases duhet të jetë e noterizuar, ku të specifikohet objekti i kontratës dhe afati i saj. ç) Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.

dd) Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruara sipas shtojcës Nr. 10. (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese).

ee) Makineritë e mësipërme nuk janë të angazhuara në kontratë të tjera dhe nuk janë të deklaruara në procedurat të shpallura fitues nga autoriteti kontraktor, UKT sha. (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese ku të deklarohet dhe vendndodhja e mjeteve në pronësi ose me qera me qellim verifikimi).

ff) (opsion) Do të organizohet një vizitë në kantier deri në datë 16.12.2019 në mënyrë të tillë që Operatorët Ekonomikë të mund të familiarizohen me kushtet lokale. Operatori i interesuar Ekonomik duhet të konfirmojë paraprakisht me shkrim synimin e tij për të marrë pjesë në këtë vizitë. Gjatë vizitës do t'u jepen informacione shtesë e shpjegime. Të gjitha kostot e Operatorëve Ekonomikë që lidhen me vizitën në kantier duhet të mbulohen nga vetë ata. Pa paragjykuar sa më sipër, dhe me kostot e risqet e veta, një operator ekonomik mund t'a vizitojë në çdo kohë vendndodhjen e kantierit, nëse një gjë e tillë është e mundur. Për të organizuar një vizitë në kantier, ju lutem drejtoni një shkresë pranë Drejtorisë së Prokurimit UKT sha.

Bashkimi i Operatoreve Ekonomikë "4 AM" sh.p.k & "Alba Konstruksion" sh.p.k kanë deklaruar në shtojcën nr.10 se disponon mjetet e mëposhtme: Për të përmbushur kriterin kamioncinë me kapacitet mbajtës min 1,5 ton- max 2 ton për secilin kamioncinë (8 cope) operatorët ekonomikë kanë paraqitur mjetet e mëposhtme:

- Kamioncinë me targa AA367NS me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 2,26 ton paraqitur nga operatori ekonomik 4AM sh.p.k.

- Kamionçinë me targa AA882PM me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 2,02 ton mjet i cili do të konsiderohet i rregullt dhe do të futet në kategorinë e mjeteve min 1,5 ton –max 2 ton.
- Kamionçinë me targa AA053XC me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 1,4 ton paraqitur nga operatori ekonomik 4AM sh.p.k.
- Kamionçinë me targa AA955RP me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 1,8 ton paraqitur nga operatori ekonomik 4AM siguruar nëpërmjet kontratës së qerasë Nr.10404/Rep,Nr.1659/I Kol.
- Kamionçinë me targa AA522JB me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 1,5 ton paraqitur nga operatori ekonomik 4AM siguruar nëpërmjet kontratës së qerasë Nr.10405/Rep,Nr.1660/I Kol.
- Kamionçinë me targa AA852OZ me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 1,61 ton paraqitur nga operatori ekonomik 4AM siguruar nëpërmjet kontratës së qerasë Nr.10406/Rep,Nr.1661/I Kol.
- Kamionçinë me targa TR7649P me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 1,52 ton paraqitur nga operatori ekonomik 4AM siguruar nëpërmjet kontratës së qerasë Nr.10406/Rep,Nr.1661/I Kol.
- Kamionçinë me targa AA233MN me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 1,52 ton paraqitur nga operatori ekonomik 4AM siguruar nëpërmjet kontratës së qerasë .
- Kamionçinë me targa AA657JY me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 1,53 ton paraqitur nga operatori ekonomik 4AM mjet i cili do të konsiderohet i rregullt dhe do të futet në kategorinë e mjeteve min 1,5 ton-max 2 ton.
- Mjeti me targa TR5800B me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 1 ton paraqitur nga operatori ekonomik Alba Konstruksion sh.p.k.
- Kamionçinë me targa AA169RP me kapacitet me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 1,85 ton paraqitur nga operatori ekonomik Alba Konstruksion sh.p.k mjet i cili do të konsiderohet i rregullt dhe do të futet në kategorinë e mjeteve min 1,5 ton-max 2 ton.

Komisioni i Vlerësimit të ofertave gjatë shqyrtimit të dokumentacionit në sistemin elektronik për mjetet me targa AA955RP, AA522JB, AA852OZ, TR7649P, AA233MN (mjete të siguruara me kontrata qeraje nga operatori ekonomik 4 AM sh.p.k) vëren se në përmbushje të kushteve të veçanta të kualifikimit të kërkuar në DST operatori ekonomik ka paraqitur leje qarkullimi, çertifikatë e kontrollit teknik, taksë vjetore,foto të mjetit si dhe çertifikatë për transport mallrash për llogari të vet. Ajo çka konstaton Komisioni i Vlerësimit të Ofertave është se çertifikatat e lëshuara për mjetet e mësipërme nga njësia vendore për transport mallrash janë cilësuar “Për llogari të vet, pra qeradhënësi e ka për përdorim vetjak. Dhënia e tyre me qera është në kundërshtim me përcaktimet në nenin 81, pika 1,2,3,4,5 dhe 7,8 “Destinacioni dhe Përdorimi i Mjeteve” i ligjit nr.8378 datë 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, në nenin 3, paragrafi 3.13 dhe 3.14 të Ligjit nr.8308, datë 18.3.1998 për “Transportet rrugore”, si dhe në nenin 41, të Ligjit nr.8308, datë 18.3.1998 për “Transportet rrugore”, ku parashikohet se: “Transporti i mallrave me qira dhe për të tretë është i ndaluar të kryhet pa licencën përkatëse.

Sa më sipër cituar bashkimi i operatoreve ekonomik nuk e përmbush kriterin e përcaktuar nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit për:

- Paraqitjen e 8 mjeteve me kapacitet mbajtës min 1,5 ton dhe max 2 ton pasi nga 8 mjete të kërkuara nga AK kanë paraqitur vetëm 3 mjete të sakta sipas tonazhit dhe dokumentacionit të kërkuar.

Për të përmbushur kriterin me kapacitet mbajtës min 5 ton- max 10 ton për secilin kamion vetëshkarkues (8 cope) operatorët ekonomikë kanë paraqitur mjetet e mëposhtme:

- Mjeti me targa AA465 PC me kapacitet mbajtës cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 11,2 ton.

- Mjeti me targa AA469PC me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 4,9 ton.

- Mjeti me targa AA718VL me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 9,3 ton mjet i cili do të konsiderohet i rregullt dhe do të futet në kategorinë e mjeteve min 5 ton-max 10 ton.

- Kamion vetëshkarkues TR3878K me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 7,76 ton mjet i cili do të konsiderohet i rregullt dhe do të futet në kategorinë e mjeteve min 5 ton-max 10 ton.

- Kamion vetëshkarkues TR3717P me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 8,2 ton mjet i cili do të konsiderohet i rregullt dhe do të futet në kategorinë e mjeteve min 5 ton-max 10 ton.

- Kamion vetëshkarkues AA025RK me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 10,03 ton mjet i cili do të konsiderohet i rregullt dhe do të futet në kategorinë e mjeteve min 5 ton-max 10 ton.

- Kamion vetëshkarkues AA106MR me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 8,7 ton mjet i siguruar nëpërmjet kontratës së qerasë nga operatori ekonomik 4 AM sh.p.k.

- Kamion vetëshkarkues AA908 me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 7,6 ton mjet i siguruar nëpërmjet kontratës së qerasë nga operatori ekonomik 4 AM sh.p.k.

- Kamion vetëshkarkues AA853ND me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 8,95 ton mjet i cili do të konsiderohet i rregullt dhe do të futet në kategorinë e mjeteve me kapacitet min 5 ton- max 10 ton.

- Kamion vetëshkarkues TR0715T me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 9,24 ton mjet i cili do të konsiderohet i rregullt dhe do të futet në kategorinë e mjeteve me kapacitet min 5 ton- max 10 ton.

- Kamion vetëshkarkues TR5923S me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 8,75 ton paraqitur nga operatori ekonomik Alba Konstruksion sh.p.k mjet i cili do të konsiderohet i rregullt dhe do të futet në kategorinë e mjeteve me kapacitet min 5 ton- max 10 ton.

Komisioni i Vlerësimit të ofertave gjatë shqyrtimit të dokumentacionit në sistemin elektronik për mjetet me targa AA106MR, AA908 mjete të siguruara me kontrata qeraje nga operatori ekonomik 4 AM sh.p.k) vëren se në përmbushje të kushteve të veçanta të kualifikimit të kërkuar në DST operatori ekonomik ka paraqitur leje qarkullimi, çertifikatë e kontrollit teknik, taksë vjetore, foto

të mjetit si dhe çertifikatë për transport mallrash për llogari të vet. Ajo çka konstaton Komisioni i Vlerësimit të Ofertave është se çertifikatat e lëshuara për mjetet e mësipërme nga njësia vendore për transport mallrash janë cilësuar “Për llogari të vet, pra qeradhënësi e ka për përdorim vetjak. Dhënia e tyre me qera është në kundërshtim me përcaktimet në nenin 81, pika 1,2,3,4,5 dhe 7,8 “Destinacioni dhe Përdorimi i Mjeteve” i ligjit nr.8378 datë 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, në nenin 3, paragrafi 3.13 dhe 3.14 të Ligjit nr.8308, datë 18.3.1998 për “Transportet rrugore”, si dhe në nenin 41, të Ligjit nr.8308, datë 18.3.1998 për “Transportet rrugore”, ku parashikohet se: “Transporti i mallrave me qira dhe për të tretë është i ndaluar të kryhet pa licencën përkatëse.

Sa më sipër cituar bashkimi i operatoreve ekonomik nuk e përmbush kriterin e përcaktuar nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit për:

Paraqitjen e 8 mjeteve me kapacitet mbajtës min 5 ton dhe max 10 ton pasi nga 8 mjete të kërkuara nga AK kanë paraqitur vetëm 7 mjete të sakta sipas tonazhit dhe dokumentacionit të kërkuar në DST. Për sa më sipër Dokumentacioni i paraqitur nga .BO”Alba Konstruksion sh.p.k &”4 AM”sh.p.k është i paplotë pasi nuk ka përmbushur kriteret e Veçanta të Kualifikimit/ Kapaciteti Teknik nuk zotëron kapacitet të mjaftueshem teknik për sa i përket mjeteve për të realizuar kontratën për këtë objekt prokurimi duke mos përmbushur Kriteret e veçanta për kualifikim, Kapaciteti Teknik dhe profesional, , cka bie në kundërshtim me pikën 1 gërma (a) dhe (b) të nenit 46 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik” i ndryshuar ku përcaktohet se: Operatorët ekonomik, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtëme që AK i vlerëson të nevojshme.....

Pra sa më sipër cituar dokumentacioni i paraqitur nga Operatori Ekonomik lidhur me shtojcën 10, është i paplotë”, nuk qëndron, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në dokumentat e tenderit, Shtojca 12, pika 16, nga ana e autoritetit kontraktor është përcaktuar kriteri: 16. Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratë (Shtojca 10).

Mjetet	Sasia	Gjendja
Kamion vetëshkarkues (kapaciteti mbajtës minimum 5(pese) ton dhe maksimumi 10(dhjete) ton për secilin kamion	8 copë	Pronësi ose me qera
Kamion vetëshkarkues (kapaciteti mbajtës minimum 12(dymbëdhjete) ton dhe maksimumi 17(shtatëmbëdhjete) ton për secilin kamion	5 Cope	Pronësi ose me qera
Kamion vetëshkarkues (kapaciteti mbajtës minimum 25 ton	4 cope	Pronësi ose me qera
Eskavator me zinxhir 0.25 m3	2 Cope	Pronësi ose me qera
Eskavator me cekic	2 cope	Pronësi ose me qera

<i>Kamionçine (kapaciteti mbajtës minimum 1.5(nje pik pesë) ton dhe maksimumi 2(dy) ton për secilin kamionçinë</i>	<i>8 cope</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Fadrome me goma</i>	<i>2 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Eskavator me goma 0.25 m3</i>	<i>2 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Sonde shpimi ø600mm deri ne 20m</i>	<i>1 cope</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Autobot uji</i>	<i>2 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Automjet per mbjellje bari</i>	<i>1 cope</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Autobetoniere</i>	<i>4 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Autopompe Betoni</i>	<i>2 cope</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Autovinc</i>	<i>3 cope</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Pompe suvatimi</i>	<i>2 cope</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Pompë Uji</i>	<i>2 cope</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Rrul ngjeshes deri ne 2 Ton</i>	<i>2 cope</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Makineri per shtresa betoni</i>	<i>1 cope</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Paisje per ngjitjen e tubave metalik</i>	<i>1 cope</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Bobcat</i>	<i>2 cope</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Minieskavator me zinxhir gome</i>	<i>2 cope</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Minifadrome</i>	<i>1 cope</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Vibrator</i>	<i>6 cope</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Matrapik</i>	<i>6 cope</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Trapan</i>	<i>4 cope</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Moto/gjenerator</i>	<i>3 cope</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Makine per ngjitje tubash HDPE</i>	<i>2 cope</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Saldatrice</i>	<i>4 cope</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Paisje per pastrim dhe lucidim pllakave dhe mermerit</i>	<i>1 cope</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Paisje ndricimi per kantier</i>	<i>1 cope</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Kompaktor ngjeshes</i>	<i>3 cope</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Kompresor ajri</i>	<i>3 cope</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Makineri CNC per prerjen te formave te crregullta</i>	<i>1 cope</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Bango per profilet e aluminit</i>	<i>1 cope</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Tranxhe</i>	<i>2 cope</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Kalander</i>	<i>2 cope</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Skela</i>	<i>2500 m2</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Vinc Karrel</i>	<i>3 Cope</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>UPS 200KVA</i>	<i>2 cope</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>

Zyrë kantieri e lëvizeshme	2 cope	Pronësi ose me qera
Nyje inerte dhe prodhim betoni	1 cope	Pronësi ose me qera

Te paraqiten mjete dhe pajisje të mbrojtjes në punë të punëtorëve, personelit si më poshtë:

- a) *Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik, Çertifikatë për transport mallrash për llogari të vetë dhe siguracionin e mjetit (te vlefshme), dhe per mjetet e siguruar me qera, dokumenti qe verteton regjistrimin e tij plus certifikaten e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit,(te vlefshme) Çertifikatë për transport mallrash për të tretë dhe me qera brenda vendit, duhet te shoqerohet me kontraten perkatese te qerese/furnizimit, e vlefshme per te gjithë periudhen e realizimit te kontrates objekt i ketij prokurimi. Në rastin e mjeteve te tjera duhet te jene aktet e çdoganimit ose faturat tatimore te blerjes.*
- b) *Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre.*
- c) *Për mjetet e marra me qera të të paraqitet kontrata përkatëse noteriale e qirasë ku të specifikohet objekti i kontratës dhe afati i saj.*
- d) *Per fabriken e prodhimit te betonit, ne rast se eshte ne pronesi duhet te paraqitet akti i pronesise i shoqeruar me leje mjedisore leshuar nga QKL. Ne rast se operatori ekonomik ka kontrate qeraje duhet te paraqitet akti i pronesise se qiradhensit shoqeruar me lejen mjedisore leshuar nga QKL.Kontrata e qerase duhet te jete e noterizuar, ku të specifikohet objekti i kontratës dhe afati i saj.*
- e) *Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.*
- f) *Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruara sipas shtojcës Nr. 10. (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese).*
- g) *Makineritë e mësipërme nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera dhe nuk jane te deklaruara ne procedurat te shpallura fitues nga autoriteti kontraktor, UKT sha. (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese ku te deklarohet dhe vendndodhja e mjeteve ne pronesi ose me qera me qellim verifikimi).*
- h) *(opsion) Do të organizohet një vizitë në kantier deri në date 16.12.2019 në mënyrë të tillë që Operatorët Ekonomikë të mund të familiarizohen me kushtet lokale.*
Operatori i interesuar Ekonomik duhet të konfirmojë paraprakisht me shkrim synimin e tij për të marrë pjesë në këtë vizitë. Gjatë vizitës do t’u jepen informacione shtesë e shpjegime. Të gjitha kostot e Operatorëve Ekonomikë që lidhen me vizitën në kantier duhet të mbulohen nga vetë ata. Pa paragjykuar sa më sipër, dhe me kostot e risqet e veta, një operator ekonomik mund t’a vizitojë në çdo kohë vendndodhjen e kantierit, nëse një gjë e tillë është e mundur.
Për të organizuar një vizitë në kantier, ju lutem drejtoni nje shkrese prane Drejtorise se Prokurimit UKT sha.

III.1.2. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të bashkimit të operatorëve ekonomikë ”Alba Konstruksion” sh.p.k. & “4 A-M” sh.p.k., rezulton se, është paraqitur dokumenti me emërtimin Kontratë Bashkim i Përkohshëm i Shoqërive ndërjmet shoqërisë “Alba Konstruksion” sh.p.k. dhe

shoqërisë “4 A-M” sh.p.k., nga ku shoqëria “Alba Konstruksion” sh.p.k. merr përsipër për realizimin e objektit ë mësipërm në masën 28.76 % dhe shoqëria ” 4 A-M” sh.p.k. merr përsipër në masën 71.24 %.

Konkretisht ndarja e punëve është përcaktuar në këtë kontratë bashkëpunimi dhe do të jetë si më poshtë vijon:

Shoqëria "ALBA KONSTRUKSION" sh.p.k. merr përsipër kryerjen e punimeve sipas përqindjes së mësipërme të bashkëpunimit për kapitujt e mëposhtem të punimeve:

- Kapitulli A-I, PUNIME DHEU & PRISHJE & RRETHIMI
- Në kapitullin A-2, PUNIME MURATURE zerat:
 - o I-2.64/2-Mur me tulle plota në lartësi deri 3m me llaç perzier M 25
 - o 2-2.108/3-Ndërtim muri me knauf t= 10 cm me dy shtresa, kundër lagështirës
- Kapitulli A-4, PUNIME SHITRESASH
- Kapitulli A-5, PUNIME SUVATIMI DHE VESHJE
- Kapitulli A-6, PUNIME DRITARE DHE DYER
- Kapitulli A-7, PUNIME BOJATISJE
- Kapitulli A-8, PUNIME TË NDRYSHME
- Kapitulli A-9, PUNIME TARACE E PASHFRYTEZUESHME
- Kapitulli A-10, PUNIME TARACE E SHFRYTEZUESHME
- Në kapitullin A-II, PUNIME FASADE XHAMI TË JASHTME DHE TË BRENDSHME zerat:
 - o 3-2.373-Vetratë xhami e temperuar për ndarje të brendshme xhami
 - o 5-Analizë-Dyer rreshkitese xhami
 - o 6-Analizë-Dyer rreshkitese xhami të brendshme
 - o 7-Analizë-Parapetë shkallë me xham + korimano druri
- Kapitulli B, SISTEMIMI I OBORRIT TË JASHTEM
- Kapitulli C.2, SISTEMI I MBROJTJES KUNDËR ZJARRIT
- Kapitulli C.3, SISTEMI HIDRAULIK

Shoqëria “Alba Konstruksion” sh.p.k. do të kontribuojë edhe në asistencë teknike duke iu përbajtur përqindjes së saj.

Shoqëria “4 A – M” sh.p.k. merr përsipër kryerjen e punimeve sipas përqindjes së mësipërme të bashkëpunimit për të gjithë zërat e punimeve që nuk do të realizohen nga Alba Konstruksion shpk.

Gjithashtu, është paraqitur edhe dokumenti Prokurë e Posaçme, sipas së cilës shoqëria “Alba Konstruksion” sh.p.k. është përfaqësuese e këtij bashkimi operatorësh ekonomikë.

III.1.3. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të bashkimit të operatorëve ekonomikë, rezulton se është paraqitur, në përmbushje të kriterit të sipërcituar si më poshtë vijon:

- I. Shoqëria “Alba Konstruksion” sh.p.k. ka paraqitur:
 - Deklaratë Mbi Disponimin e Makinerive ku janë deklaruar këto mjete:

Ne pronesi				
Lloji i Mjetit	Targa	Nr. Lejes qarkullimit	Nr. Shasise	Te tjera
Autovinc	TR5800B	TR0109928	12534239	Ne pronesi
Autovinc	TR5923S	TR0099682	WDB621107 15262364	Ne pronesi
Kamion veteshkarkues kapaciteti mbajtes minimum 5(pese) ton dhe maksimumi 10(dhjete) ton	TR5032S	TR0098452	WDB952314 1K394351	Ne pronesi
Kamion veteshkarkues kapaciteti mbajtes minimum 12(Dymbdhejete) ton dhe maksimumi 17(Shtatembdhet e) ton	AA126BI	TRDA2951916	WMAT4620 47L018203	Ne pronesi
Kamioncine kapaciteti mbajtes minimum 1.5(nje pike pese) ton dhe maksimumi 2(dy) ton	AA169RP	TRDA2205317	WMB906255 1N398762	Ne pronesi
Motogjenerator Cope 3				Ne pronesi me fature TVSH
Matrapik Cope 2				Ne pronesi me fature TVSH
Pompe Suvatimi Cope 2				
Vibrator Betoni Cope 4				Ne pronesi me fature TVSH
Zyre kantieri e levizeshme Cope 1				Ne pronesi me Akt – Zhdoganimi
Makineri per ngjitje tubash				Ne pronesi me fature TVSH

HDPE Cope 2				
Eskavator me zinxhir 0.25m ³			KMTPC180C 55K54330	Ne pronesi me Akt – Zhdoganimi
Minieskavator me zinxhir gome			SLP080805E 1024723	Ne pronesi me Akt – Zhdoganimi
Minieskavator me zinxhir gome			JCB08016J71 155963	Ne pronesi me Akt – Zhdoganimi
Saldatrice Cope 2				Ne pronesi me fature TVSH

- Referuar Deklaratës së mësipërme ndërmjet të tjerave, është paraqitur dokumentacion për mjetet e deklaruara si më poshtë:
 - Autovinc me targë TR5800 B (sipas emërimit tek deklarata) me kapacitet mbajtës 1 ton, në pronësi, shoqëruar me leje qarkullimi, certifikatë pronësie, dokumenti i pagimit të taksave vjetore, certifikatë e kontrollit teknik, policën e sigurimit të mjetit, foto e mjetit;
 - Autovinc me targë TR 5923 S (sipas emërimit tek deklarata) me kapacitet mbajtës 8.85 ton, në pronësi, shoqëruar me leje qarkullimi, certifikatë pronësie, certifikatë e kontrollit teknik, policën e sigurimit të mjetit, certifikatë për transport për të tretë dhe me qera, foto e mjetit;
 - Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës minimumi 5 ton dhe maksimumi 10 ton (sipas emërimit tek deklarata) me targë TR 5032 S, në pronësi, me kapacitet mbajtës 16.68 ton, leje qarkullimi, certifikatë e pronësisë, certifikatë e kontrollit teknik, policë e sigurimit të mjetit, certifikatë e kontrollit teknik për të tretë dhe me qera; foto e mjetit;
 - Kamioncinë kapaciteti mbajtës minimum 1.5 ton dhe maksimumi 2 ton (sipas emërimit tek deklarata) me targë AA 169 RP, në pronësi, me kapacitet mbajtës 1.85 ton, certifikatë e pronësisë, certifikatë e kontrollit teknik, policë e sigurimit të

mjetit, certifikatë për transport mallrash për nevojat e veta brenda vendit, foto e mjetit.

II. Shoqëria “4 A – M” sh.p.k. ka paraqitur:

- Deklaratë Mbi Disponimin e Makinerive ku janë deklaruar ndërmjet të tjerave edhe këto mjete:

Ne pronesi				
Lloji i Mjetit	Targa	Nr. Lejes qarkullimit	Nr. Shasisë	Te tjera
Kamion vetëshkarkues	AA987XI	TRDA1193319	WDB932325 1L235687	Ne pronesi
Kamion vetëshkarkues	AA605SB	TRDA3215417	WJM4CP80 0C044336	Ne pronesi
Kamion vetëshkarkues	AA637NX	TRF1438516	WJM4CSS2 0C167871	Ne pronesi
Kamion vetëshkarkues	AA639NX	TRF1438816	WJM4CSS2 0C168027	Ne pronesi
Kamion vetëshkarkues	AA640NX	TRF1439116	WJM4CSS2 0C167870	Ne pronesi
Kamion vetëshkarkues	AA641NX	TRF1439216	WJM4CSS2 0C167952	Ne pronesi
Kamion vetëshkarkues	AA847LH	TRDA1730115	WDB952314 1K812115	Ne pronesi
Eskavator me zinxhir 0.25 m3			CAT0325CP CSJ00922	Ne pronesi me fature TVSH
Eskavator me zinxhir 0.25 m3			CAT0345BK CCC00696	Ne pronesi me fature TVSH
Eskavator me cekic			WLHZ1337P 2C033944	Ne pronesi me akt-zhdoganimi
Eskavator me cekic			WLHZ1337H ZC042606	Ne pronesi me akt-zhdoganimi
Kamionçine	AA367NS	TRDA1803416	ZCFC50A00 05471828	Ne pronesi
Kamionçine	AA882PM	TRDA0059017	WDB904622 1R788120	Ne pronesi
Kamionçine	AA053XC	TRDA0456019	WDB906253 1N632510	Ne pronesi
Fadrome me goma	AHMT05	TRDA2994618	CAT0432DP WEP02397	Ne pronesi
Fadrome me goma	AHMT 74	TRDA0630519	402049	Ne pronesi
Eskavator me goma 0.25 m3	ABMT22	TRDA7732912	CATM316CJ BDX00842	Ne pronesi
Eskavator me goma 0.25 m3	AFMT35	TRDA1581817	297677	Ne pronesi
Autobot uji	AA165SB	TRDA3205417	XLRAS47XS 0E677990	Ne pronesi
Autobot uji	AA597MD	TRDA6845315	CH61712615 129243	Ne pronesi



Autobetoniere	AA601VA	TRDA4141618	WJMJ4CS80 0C077862	Ne pronesi
Autobetoniere	AA982XI	TRDA1189119	WDB930163 5L043429	Ne pronesi
Autobetoniere	AA983XI	TRDA1189319	NMB3753741 2067578	Ne pronesi
Autobetoniere	AA988XI	TRDA1193519	WDB9301635 L041134	Ne pronesi
Autopompe Betoni	AA887VL	TRDA5035918	WDB625115 1K087307	Ne pronesi
Autopompe Betoni	AA417XY	TRDA2422619	WMAF14319 3M198006	Ne pronesi
Autovinc	AA465PC	TRDA5941416	WDB950032 1K520974	Ne pronesi
Autovinc	AA469PC	TRDA5941516	WDB675147 15547376	Ne pronesi
Autovinc	AA718VL	TRDA5013718	WDB930142 1K867817	Ne pronesi
Pompe suvatimi Cope 2				Ne pronesi me fature TVSH
Pompë Uji Cope 2				Ne pronesi me fature TVSH
Rrul ngjeshes deri ne 2 Ton			10146050045 9	Ne pronesi me Akt – Zhdoganim
Rrul ngjeshes deri ne 2 Ton			6070	Ne pronesi me Akt – Zhdoganim
Makineri per shtresa betoni	AGR339	Trda0455519	WBPAACB1 0CA000048	Ne pronesi
Paisje per ngjitjen e tubave metalik				Ne pronesi me Akt – Zhdoganim
Bobcat	ACMT16	TRDA3445715	LMU0L170N 8M469056	Ne pronesi
Bobcat	AFMT46	TRDA3005717	454105	Ne pronesi
Minieskavator me zinxhir gome			CAT0303CC BXT04133	Ne pronesi me Akt – Zhdoganim
Minieskavator me zinxhir gome			JCB08030E8 1230082	Ne pronesi me Akt – Zhdoganim
Minifadrome	AFMT41	TRDA2528017	0808356	Ne pronesi
Vibrator Cope 6				Ne pronesi me fature TVSH
Matrapik Cope 6				Ne pronesi me fature TVSH
Trapan Cope 4				Ne pronesi me fature TVSH
Moto/gjenerator Cope 3				Ne pronesi me fature TVSH
Makine per ngjitje tubash HDPE Cope 2				Ne pronesi me fature TVSH
Saldatrice Cope 4				Ne pronesi me fature TVSH
Paisje per pastrim dhe lucidim pllakave dhe mermerit				Ne pronesi me Akt Zhdoganim



Paisje ndricimi per kantier	AGR348	TRDA0736819	1405015	Ne pronesi
Kompaktor ngjeshes Cope 3				Ne pronesi me fature TVSH
Kompresor ajri Cope 3				Ne pronesi me fature TVSH
Tranxhe Cope 2				Ne pronesi me fature TVSH
Kalander Cope 2				Ne pronesi me fature TVSH
Skela 2500m²				Ne pronesi me fature TVSH
Vinc Karrel Cope 3				Ne pronesi me fature TVSH
UPS 200KVA Cope 2				Ne pronesi me fature TVSH
Zyrë kantieri e lëvizeshme Cope 2				Ne pronesi me Akt – Zhdognimi
Nyje inerte dhe prodhim betoni				Ne pronesi

Mjete me qera

Lloji i mjetit	Targa e mjetit	Nr. Lejes se qarkullimit	Nr. Shasisë	Nr.kontrates se qerases	Afati i kontrates se qerases(data e fillimit dhe mbarimit)
Kamion vetëshkarkues	TR3878K	TR0013897	WMA5200610M060569	Nr.10407 Rep Nr.1662/1 Kol	Deri ne realizimin e plote te kontrates
Kamion vetëshkarkues	TR3717P	TR0064454	38913414796036	Nr.10407 Rep Nr.1662/1 Kol	Deri ne realizimin e plote te kontrates
Kamion vetëshkarkues	AA025RK	VLD0335117	WMAH20ZZ55M423738	Nr.10407 Rep Nr.1662/1 Kol	Deri ne realizimin e plote te kontrates
Kamion vetëshkarkues	AA526KD	TRDB7992914	YV2A4DMC81B296725	Nr.10407 Rep Nr.1662/1 Kol	Deri ne realizimin e plote te kontrates
Kamionçine	AA955RP	TRDA2525517	ZCFC4970002920423	Nr.10404 Rep Nr.1659/1 Kol	Deri ne realizimin e plote te kontrates
Kamion vetëshkarkues	AA106MR	TRDA8553715	VF644ACA00002534	Nr.10405 Rep Nr.1660/1 Kol	Deri ne realizimin e plote te kontrates
Kamion vetëshkarkues	AA908MB	TRDA6490815	ZCFA1LG0002058239	Nr.10405 Rep Nr.1660/1 Kol	Deri ne realizimin e plote te kontrates



Kamion vetëshkarkues	AA946HP	TRDB6923013	XLEP6X400 05113793	Nr.10405 Rep Nr.1660/1 Kol	Deri ne realizimin e plote te kontrates
Kamionçine	AA522JB	TRDB2272414	WDB903422 1P626775	Nr.10405 Rep Nr.1660/1 Kol	Deri ne realizimin e plote te kontrates
Automjet per mbjellje bari				Nr.10405 Rep Nr.1660/1 Kol	Deri ne realizimin e plote te kontrates
Makineri CNC per prerjen te formave te crregullta				Nr.10403 Rep Nr.1658/1 Kol	Deri ne realizimin e plote te kontrates
Bango per profilet e aluminit				Nr.10403 Rep Nr.1658/1 Kol	Deri ne realizimin e plote te kontrates
Sonde shpimi ø600 deri ne 20m				Nr.10402 Rep Nr.1657/1 Kol	Deri ne realizimin e plote te kontrates
Kamionçine	AA852OZ	TRDA0007516	WDB903422 1P733712	Nr.10406 Rep Nr.1661/1 Kol	Deri ne realizimin e plote te kontrates
Kamionçine	TR7649P	TRF0523315	60231618151 767	Nr.10406 Rep Nr.1661/1 Kol	Deri ne realizimin e plote te kontrates
Kamion vetëshkarkues	TR3485T	TRF0134614	XLEPH6X2Z 04279432	Nr.10406 Rep Nr.1661/1 Kol	Deri ne realizimin e plote te kontrates
Kamion vetëshkarkues	AA993OG	TRDA3611616	WDB950306 1K842551	Nr.10408 Rep Nr.1663/1 Kol	Deri ne realizimin e plote te kontrates
Kamion vetëshkarkues	AA853ND	TRDA3849617	VLUP4X200 09017916	Nr.10408 Rep Nr.1663/1 Kol	Deri ne realizimin e plote te kontrates
Kamion vetëshkarkues	TR0715T	TRF0673313	WMAL87ZZ ZYY057384	Nr.10408 Rep Nr.1663/1 Kol	Deri ne realizimin e plote te kontrates
Kamionçine	AA233MN	TRDA8200715	WDB903661 1R594856	Nr.10630 Rep Nr.1708/1 Kol	Deri ne realizimin e plote te kontrates

				Kol	
Kamionçine	AA657JY	ELF0417314	WDB667302 10912882	Nr.10631 Rep Nr.1709/1 Kol	Deri ne realizimin e plote te kontrates

- Referuar Deklaratës së mësipërme është paraqitur dokumentacion për mjetet e deklaruara si më poshtë:
 - Kamion vetëshkarkues me targë AA 987 XI (sipas emërimit tek deklarata) me kapacitet mbajtës 16.82 ton, në pronësi, shoqëruar me leje qarkullimi, certifikatë pronësie, dokumenti i pagimit të taksave vjetore, certifikatë e kontrollit teknik, policën e sigurimit të mjetit, foto e mjetit; çertifikatë për transport ndërkombëtar mallrash për të tretë dhe me qira,

- Kamion vetëshkarkues me targë AA605 SB (sipas emërimit tek deklarata) me kapacitet mbajtës 15.4 ton, në pronësi, shoqëruar me leje qarkullimi, dokumenti i pagimit të taksave vjetore, certifikatë pronësie, dokumenti i pagimit të taksave vjetore, certifikatë e kontrollit teknik, policën e sigurimit të mjetit, foto e mjetit; certifikatë për transport ndërkombëtar mallrash për të tretë dhe me qira,
- Kamion vetëshkarkues me targë AA 637 NX (sipas emërimit tek deklarata) me kapacitet mbajtës 28.7 ton, në pronësi, shoqëruar me leje qarkullimi, certifikatë pronësie, dokumenti i pagimit të taksave vjetore, certifikatë e kontrollit teknik, policën e sigurimit të mjetit, foto e mjetit; certifikatë për transport ndërkombëtar mallrash për të tretë dhe me qira,
- Kamion vetëshkarkues me targë AA 639 NX (sipas emërimit tek deklarata) me kapacitet mbajtës 28.7 ton, në pronësi, shoqëruar me leje qarkullimi, certifikatë pronësie, dokumenti i pagimit të taksave vjetore, certifikatë e kontrollit teknik, policën e sigurimit të mjetit, foto e mjetit; certifikatë për transport ndërkombëtar mallrash për të tretë dhe me qira,
- Kamion vetëshkarkues me targë AA 640 NX (sipas emërimit tek deklarata) me kapacitet mbajtës 28.7 ton, në pronësi, shoqëruar me leje qarkullimi, certifikatë pronësie, dokumenti i pagimit të taksave vjetore, certifikatë e kontrollit teknik, policën e sigurimit të mjetit, foto e mjetit; certifikatë për transport ndërkombëtar mallrash për të tretë dhe me qira
- Kamion vetëshkarkues me targë AA 641 NX (sipas emërimit tek deklarata) me kapacitet mbajtës 28.7 ton, në pronësi, shoqëruar me leje qarkullimi, certifikatë pronësie, dokumenti i pagimit të taksave vjetore, certifikatë e kontrollit teknik, policën e sigurimit të mjetit, foto e mjetit; certifikatë për transport ndërkombëtar mallrash për të tretë dhe me qira,
- Kamion vetëshkarkues me targë AA 847 LH (sipas emërimit tek deklarata) me kapacitet mbajtës 25.67 ton, në pronësi, shoqëruar me leje qarkullimi, certifikatë pronësie, dokumenti i pagimit të taksave vjetore, certifikatë e kontrollit teknik, policën e sigurimit të mjetit, foto e mjetit; certifikatë për transport mallrash brenda vendit për llogari të vet, certifikatë për transport ndërkombëtar mallrash për të tretë dhe me qira,
- Kamioncinë me targë AA 367 NS (sipas emërimit tek deklarata) me kapacitet mbajtës 2.26 ton, në pronësi, shoqëruar me leje qarkullimi, certifikatë pronësie, dokumenti i pagimit të taksave vjetore, certifikatë e kontrollit teknik, policën e sigurimit të mjetit, foto e mjetit; certifikatë për transport mallrash brenda vendit për llogari të vet
- Kamioncinë me targë AA 882 PM (sipas emërimit tek deklarata) me kapacitet mbajtës 2.02 ton, në pronësi, shoqëruar me leje qarkullimi, certifikatë pronësie, dokumenti i pagimit të taksave vjetore, certifikatë e kontrollit teknik, policën e sigurimit të mjetit, foto e mjetit; certifikatë për transport mallrash brenda vendit për llogari të vet

- Kamioncinë me targë AA 053 XC (sipas emërimit tek deklarata) me kapacitet mbajtës 1.4 ton, në pronësi, shoqëruar me leje qarkullimi, certifikatë pronësie, dokumenti i pagimit të taksave vjetore, certifikatë e kontrollit teknik, policën e sigurimit të mjetit, foto e mjetit;
- Autobot uji me targë AA 165 SB (sipas emërimit tek deklarata) me kapacitet mbajtës 16.15 ton, në pronësi, shoqëruar me leje qarkullimi, certifikatë pronësie, dokumenti i pagimit të taksave vjetore, certifikatë e kontrollit teknik, policën e sigurimit të mjetit, foto e mjetit; certifikatë për transport mallrash brenda vendit për llogari të vet
- Autobot uji me targë AA 597 MD (sipas emërimit tek deklarata) me kapacitet mbajtës 7.5 ton, në pronësi, shoqëruar me leje qarkullimi, certifikatë pronësie, dokumenti i pagimit të taksave vjetore, certifikatë e kontrollit teknik, policën e sigurimit të mjetit, foto e mjetit; certifikatë për transport mallrash brenda vendit për llogari të vet
- Autopompë betoni me targë AA 417 XY (sipas emërimit tek deklarata) me kapacitet mbajtës 2.4 ton, në pronësi, shoqëruar me leje qarkullimi, certifikatë pronësie, dokumenti i pagimit të taksave vjetore, certifikatë e kontrollit teknik, policën e sigurimit të mjetit, foto e mjetit; certifikatë për transport mallrash brenda vendit për llogari të vet
- Autovinc me targë AA 465 PC (sipas emërimit tek deklarata) me kapacitet mbajtës 11.26 ton, në pronësi, shoqëruar me leje qarkullimi, certifikatë pronësie, certifikatë e kontrollit teknik, policën e sigurimit të mjetit, foto e mjetit; certifikatë për transport mallrash brenda vendit për llogari të vet
- Autovinc me targë AA 469 PC (sipas emërimit tek deklarata) me kapacitet mbajtës 4.9 ton, në pronësi, shoqëruar me leje qarkullimi, certifikatë pronësie, certifikatë e kontrollit teknik, policën e sigurimit të mjetit, foto e mjetit; certifikatë për transport mallrash brenda vendit për llogari të vet;
- Autovinc me targë AA 718 VL (sipas emërimit tek deklarata) me kapacitet mbajtës 9.31 ton, në pronësi, shoqëruar me leje qarkullimi, certifikatë pronësie, certifikatë e kontrollit teknik, policën e sigurimit të mjetit, foto e mjetit; certifikatë për transport mallrash brenda vendit për llogari të vet;
- Kamion vetëshkarkues me targë TR 3878 K (sipas emërimit tek deklarata) me kapacitet mbajtës 7.76 ton, me qera, shoqëruar me kontratë qeraje ndërjmet qeradhënësit “Rafaelo 2002” sh.a. dhe qeramarrësit “4 A – M” sh.p.k, leje qarkullimi, certifikatë pronësie, dokumenti i pagimit të taksave vjetore, certifikatë e kontrollit teknik, policën e sigurimit të mjetit, foto e mjetit; certifikatë për transport mallrash për të tretë dhe me qera brenda vendit;
- Kamion vetëshkarkues me targë TR 3717 P (sipas emërimit tek deklarata) me kapacitet mbajtës 8.2 ton, me qera, shoqëruar me kontratë qeraje ndërjmet qeradhënësit “Rafaelo 2002” sh.a. dhe qeramarrësit “4 A – M” sh.p.k, leje qarkullimi, certifikatë pronësie, dokumenti i pagimit të taksave vjetore, certifikatë

- e kontrollit teknik, policën e sigurimit të mjetit, foto e mjetit; çertifikatë për transport mallrash për të tretë dhe me qera brenda vendit;
- Kamion vetëshkarkues me targë AA 025 RK (sipas emërimit tek deklarata) me kapacitet mbajtës 9.97 ton, me qera, shoqëruar me kontratë qeraje ndërjmet qeradhënësit “Rafaelo 2002” sh.a. dhe qeramarrësit “4 A – M” sh.p.k, leje qarkullimi, certifikatë pronësie, dokumenti i pagimit të taksave vjetore, certifikatë e kontrollit teknik, policën e sigurimit të mjetit, foto e mjetit; çertifikatë për transport mallrash për të tretë dhe me qera brenda vendit;
 - Kamion vetëshkarkues me targë AA 526 KD (sipas emërimit tek deklarata) me kapacitet mbajtës 12.46 ton, me qera, shoqëruar me kontratë qeraje ndërjmet qeradhënësit “Rafaelo 2002” sh.a. dhe qeramarrësit “4 A – M” sh.p.k, leje qarkullimi, certifikatë pronësie, certifikatë e kontrollit teknik, policën e sigurimit të mjetit, foto e mjetit; çertifikatë për transport mallrash për të tretë dhe me qera brenda vendit;
 - Kamion vetëshkarkues me targë AA 955 RP (sipas emërimit tek deklarata) me kapacitet mbajtës 1.8 ton, me qera, shoqëruar me kontratë qeraje ndërjmet qeradhënësit “Dabar” sh.p.k. dhe qeramarrësit “4 A – M” sh.p.k., leje qarkullimi, certifikatë pronësie, certifikatë e kontrollit teknik, policën e sigurimit të mjetit, foto e mjetit; çertifikatë për transport mallrash brenda vendit për llogari të vet në përdorim të “Dabar” sh.p.k.
 - Kamion vetëshkarkues me targë AA 106 MR (sipas emërimit tek deklarata) me kapacitet mbajtës 8.7 ton, me qera, shoqëruar me kontratë qeraje ndërjmet qeradhënësit “Garden Line” sh.p.k. dhe qeramarrësit “4 A – M” sh.p.k., leje qarkullimi, certifikatë pronësie, dokumenti i pagimit të taksave vjetore, certifikatë e kontrollit teknik, policën e sigurimit të mjetit, foto e mjetit; çertifikatë për transport mallrash për nevojat e veta brenda vendit në përdorim të “Garden Line” sh.p.k.
 - Kamion vetëshkarkues me targë AA 908 MB (sipas emërimit tek deklarata) me kapacitet mbajtës 7.6 ton, me qera, shoqëruar me kontratë qeraje ndërjmet qeradhënësit “Garden Line” sh.p.k. dhe qeramarrësit “4 A – M” sh.p.k., leje qarkullimi, certifikatë pronësie, dokumenti i pagimit të taksave vjetore, certifikatë e kontrollit teknik, policën e sigurimit të mjetit, foto e mjetit; çertifikatë për transport mallrash për nevojat e veta brenda vendit në përdorim të “Garden Line” sh.p.k.
 - Kamion vetëshkarkues me targë AA 946 HP (sipas emërimit tek deklarata) me kapacitet mbajtës 9.55 ton, me qera, shoqëruar me kontratë qeraje ndërjmet qeradhënësit “Garden Line” sh.p.k. dhe qeramarrësit “4 A – M” sh.p.k., leje qarkullimi, certifikatë pronësie, dokumenti i pagimit të taksave vjetore, certifikatë e kontrollit teknik, policën e sigurimit të mjetit, foto e mjetit; çertifikatë për transport mallrash për nevojat e veta brenda vendit në përdorim të “Garden Line” sh.p.k.

- Kamioncine me targë AA 522 JB (sipas emërimit tek deklarata) me kapacitet mbajtës 1.52 ton, me qera, shoqëruar me kontratë qeraje ndërjmet qeradhënësit “Garden Line” sh.p.k. dhe qeramarrësit “4 A – M” sh.p.k., leje qarkullimi, certifikatë pronësie, dokumenti i pagimit të taksave vjetore, certifikatë e kontrollit teknik, policën e sigurimit të mjetit, certifikatë për transport mallrash për nevojat e veta brenda vendit në përdorim të “Garden Line” sh.p.k.
- Kamioncine me targë AA 852 OZ (sipas emërimit tek deklarata) me kapacitet mbajtës 1.61 ton, me qera, shoqëruar me kontratë qeraje ndërjmet qeradhënësit “I.D.K. - Konstruksion” sh.p.k. dhe qeramarrësit “4 A – M” sh.p.k., leje qarkullimi, certifikatë pronësie, dokumenti i pagimit të taksave vjetore, certifikatë e kontrollit teknik, policën e sigurimit të mjetit, foto e mjetit; certifikatë për transport mallrash brenda vendit për llogari të vet në përdorim të “I.D.K. - Konstruksion” sh.p.k.
- Kamioncine me targë TR 7649 P (sipas emërimit tek deklarata) me kapacitet mbajtës 1.52 ton, me qera, shoqëruar me kontratë qeraje ndërjmet qeradhënësit “I.D.K. - Konstruksion” sh.p.k. dhe qeramarrësit “4 A – M” sh.p.k., leje qarkullimi, certifikatë pronësie, dokumenti i pagimit të taksave vjetore, certifikatë e kontrollit teknik, policën e sigurimit të mjetit, foto e mjetit; certifikatë për transport mallrash brenda vendit për llogari të vet në përdorim të “I.D.K. - Konstruksion” sh.p.k.
- Kamion vetëshkarkues me targë AA 853 ND (sipas emërimit tek deklarata) me kapacitet mbajtës 8.95 ton, me qera, shoqëruar me kontratë qeraje ndërjmet qeradhënësit “Arjel” sh.p.k. dhe qeramarrësit “4 A – M” sh.p.k., leje qarkullimi, certifikatë pronësie, dokumenti i pagimit të taksave vjetore, certifikatë e kontrollit teknik, policën e sigurimit të mjetit, foto e mjetit; certifikatë për transport mallrash për të tretë dhe me qera;
- Kamion vetëshkarkues me targë TR 0715 T (sipas emërimit tek deklarata) me kapacitet mbajtës 9.24 ton, me qera, shoqëruar me kontratë qeraje ndërjmet qeradhënësit “Arjel” sh.p.k. dhe qeramarrësit “4 A – M” sh.p.k., leje qarkullimi, certifikatë pronësie, dokumenti i pagimit të taksave vjetore, certifikatë e kontrollit teknik, policën e sigurimit të mjetit, foto e mjetit; certifikatë për transport mallrash për të tretë dhe me qera;
- Kamioncine me targë AA 233 MN (sipas emërimit tek deklarata) me kapacitet mbajtës 1.52 ton, me qera, shoqëruar me kontratë qeraje ndërjmet qeradhënësit “Ed Konstruksion” sh.p.k. dhe qeramarrësit “4 A – M” sh.p.k., leje qarkullimi, certifikatë pronësie, dokumenti i pagimit të taksave vjetore, certifikatë e kontrollit teknik, policën e sigurimit të mjetit, foto e mjetit; certifikatë për transport mallrash brenda vendit për llogari të vet në përdorim të “Ed Konstruksion” sh.p.k.
- Kamioncine me targë AA 657 JY (sipas emërimit tek deklarata) me kapacitet mbajtës 1.53 ton, me qera, shoqëruar me kontratë qeraje ndërjmet qeradhënësit “Ergi” sh.p.k. dhe qeramarrësit “4 A – M” sh.p.k., leje qarkullimi, certifikatë pronësie, certifikatë e kontrollit teknik, policën e sigurimit të mjetit, foto e mjetit; certifikatë për transport mallrash për të tretë dhe me qera;

III.1.4. Në nenin 46, pika 1, gërma “b” të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese”*.

III.1.5. Ndërsa në nenin 53, pika 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...”*.

III.1.6. Nga verifikimi i ofertës së paraqitur nga bashkimi i përkohshëm i shoqërive të mësipërme rezulton se ka mangësi në plotësimin e kriterit për mjetet. Konkretisht, nga dokumentacioni i paraqitur, konstatohet se, në kontratën e bashkëpunimit ndërmjet operatorëve ekonomikë “Alba Konstruksion” sh.p.k. dhe “4 A -M” sh.p.k. përveç përcaktimit të përqindjes dhe ndarjes së zërave të shërbimeve konkrete që do të kryejë secili, në nenin 2 të saj, është përcaktuar: *“Shoqëria “4 A – M” sh.p.k. dhe shoqëria “Alba Konstruksion” sh.p.k. bashkojnë kapitalet, makineritë, fuqinë punëtore, bilancet e tyre e të tjera dhe janë përgjegjëse solidarë për punimet e kryera, detyrimet kontraktuale dhe në mënyrë të veçantë për zbatimin e kushteve të kontratës dhe të grafikut të punimeve”*.

Në nenin 5 të saj është përcaktuar: *“Palët bien dakord që të themelojnë në rolin e kordinatorit të këtij grupi një staf indipendent, detyrat e përgjegjësive të cilat do të përcaktohen në një kontratë të detajuar në rastin e shpalljes fitues të këtij grupi”*.

Nga mjetet e paraqitura nga ky bashkim operatorësh ekonomikë për plotësimin e kriterit të mjeteve kamioncine me kapacitet mbajtës minimumi 1.5 ton dhe maksimumi 2 ton; kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës minimumi 5 ton dhe maksimumi 10 ton, për të cilat autoriteti kontraktor ka përcaktuar kërkesat: *“Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik, Certifikatë për transport mallrash për llogari të vetë dhe siguracionin e mjetit (te vlefshme), dhe për mjetet e siguruara me qera, dokumenti që verteton regjistrimin e tij plus certifikaten e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit,(te vlefshme) Certifikatë për transport mallrash për të tretë dhe me qera brenda vendit, duhet të shoqerohet me kontratën perkatese të qerave/furnizimit, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi.*

Në rastin e mjeteve të tjera duhet të jenë aktet e çdoganimit ose faturat tatimore të blerjes.

Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre.

Për mjetet e marra me qera të të paraqitet kontrata përkatëse noteriale e qirasë ku të specifikohet objekti i kontratës dhe afati i saj”, nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur nga ankimuesi në lidhje me makineritë, konstatohet se jo të gjitha mjetet e paraqitura janë të rregullta në kuptim të plotësimit të kriterëve të përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit.

Konkretisht, edhe vetë ankimuesi pretendon se: *“Kemi paraqitur këto mjete:*

Shoqëria 4 AM

AA 367 NS 2.26 ton (në pronësi)

AA 882 PM 2.02 ton (në pronësi)

AA 053 XC 1.4 ton (në pronësi)

AA 955 RP 1.8 ton (me qera)

AA 522 JB 1.5 ton (me qera)

AA 852 OZ 1.61 ton (me qera)

TR 7649 P 1.52 ton (me qera)

AA 233 MN 1.52 ton (me qera)

AA 657 JY 1.53 ton (me qera)

Shoqëria Alba Konstruksion

AA 169 RP 1.85 ton (në pronësi)

Shoqëria 4 AM

Kamion TR 3878 K 7.76 ton (me qera)

Kamion TR 3717 P 8.2 ton (me qera)

Kamion AA 025 RK 9.97 ton (me qera)

Kamion AA 106 MR 8.7 ton (me qera)

Kamion AA 908 MB 7.6 ton (me qera)

Kamion AA 946 HP 9.5 ton (me qera)

Kamion AA 853 ND 9 ton (me qera)

Kamion TR 0715 T 9.24 ton (me qera)

Shoqëria Alba Konstruksion

Kamion TR 5923 S 8.75 ton (në pronësi)

III.1.6. Nga verifikimi rezulton se mjetet me targë AA 367 NS 2.26 ton (në pronësi), AA 882 PM 2.02 ton (në pronësi), AA 053 XC 1.4 ton (në pronësi), nuk meren në konsideratë pasi janë mjete me kapacitete jo sipas përcaktimeve të bëra nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit; Mjetet AA 955 RP 1.8 ton (me qera), AA 522 JB 1.52 ton (me qera), AA 852 OZ 1.61 ton (me qera), TR 7649 P 1.52 ton (me qera), AA 233 MN 1.52 ton (me qera), Kamion AA 106 MR 8.7 ton (me qera), Kamion AA 908 MB 7.6 ton (me qera), nuk meren në konsideratë dhe janë mjete që nuk plotësojnë kriteret e përcaktuara nga autoriteti në dokumentat e tenderit, pasi konkretisht këto mjete nuk janë të pajisura me certifikatë për transport mallrash për të tretë dhe me qera brenda vendit, në kushtet kur këto mjete janë të marra me qera, pasi këto mjete kanë vetëm certifikatë për transport marllrash për llogari të vet.

III.1.7. Në nenin 81, pika 1,2,3,4,5 dhe 7,8 “Destinacioni dhe Përdorimi i Mjeteve” i ligjit nr.8378 datë 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar parashikohet se: 13 “[...] 1. Me destinacion të mjetit nënkuptohet përdorimi i tij në bazë të karakteristikave teknike. 2. Me përdorim të mjetit nënkuptohet shfrytëzimi i tij ekonomik 3. Mjetet mund të caktohen për përdorim vetjak ose për përdorim nga të tretët. 4. Quhet përdorim nga të tretët kur mjetet shfrytëzohen, kundrejt pagesës përkatëse, nga persona të tjerë të ndryshëm nga titullari i lejes së qarkullimit. Për rastet e tjera nënkuptohet përdorimi vetjak i mjetit. 5. Përdorimi nga të tretët përfshin: a) dhënien me qira pa drejtues mjeti; b) dhënien me qira me drejtues mjeti dhe shërbimi taksi për

transport njerëzish; c) shërbimin e linjës për transport pasagjerësh; d) shërbimin e transportit të mallrave për llogari të të treta; e) shërbimin e linjës për transportin e mallrave; f) shërbimin taksi për transportin e mallrave për llogari të të treta. 7. Në aktet në zbatim janë përcaktuar karakteristikat konstruktive të mjetit në lidhje me destinacionin ose përdorimet, për të cilat ai mund të caktohet. 8. Duke përjashtuar dispozitat e ligjeve të posaçme, cilido që shfrytëzon një mjet me një destinacion ose për një përdorim të ndryshëm nga ato të treguara në lejen e transportit, ndëshkohet me masë administrative me gjobë nga pesë mijë deri në njëzet mijë lekë. [...]”.

Në nenin 3, paragrafi 3.13 dhe 3.14 të ligjit nr. 8308, datë 18.3.1998 “Për transportet rrugore”, i ndryshuar, parashikohet se: “[...] 3.13. Transport për vete: transporti i mallrave me kamion, në ardhje ose në kthim, vetëm për llogari të veprimtarisë së vet. Në këtë rast transporti është vetëm një veprimtari ndihmëse e veprimtarisë kryesore, e cila vërtetohet sipas ligjeve në fuqi. 3.14. Transport për të tretë dhe me qira: transporti i mallrave me kamion për persona fizikë a juridikë të tjerë ose dhënia e kamionit me qira. [...]”. Në nenin 41, të ligjit nr. 8308, datë 18.3.1998 “Për transportet rrugore”, i ndryshuar, parashikohet se: “Transporti i mallrave me qira dhe për të tretë është i ndaluar të kryhet pa licencën përkatëse.”

III.1.8. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, ligji “Për Transportet Rrugore”, bën qartësisht ndarjen midis certifikatës së lëshuar për “Transport për vete” përmes të cilës subjektet mund të kryejnë transport të mallrave me kamion, në ardhje ose në kthim, vetëm për llogari të veprimtarisë së vet, ku në këtë rast transporti është vetëm një veprimtari ndihmëse e veprimtarisë kryesore, e cila vërtetohet sipas ligjeve në fuqi; si edhe certifikatës së lëshuar për “Transport për të tretë dhe me qira” përmes të cilës subjektet mund të kryejnë transport të mallrave me kamion për persona fizikë a juridikë të tjerë ose dhënia e kamionit me qira. Në rastin konkret përmes dokumentacionit të dorëzuar vërtetohet se certifikata e mjeteve të sipërcituara të marra me qera, të cilat sipas lejes së qarkullimit i disponojnë shoqëritë qeradhënëse, janë specifike dhe lëshuar vetëm për transport për vete, përmes së cilës është i licencuar vetëm ky subjekt qeradhënësi dhe është dhënë në përdorim në emër të personave fizikë qeradhënësi, për transport të mallrave me kamion, brenda vendit, vetëm për llogari të veprimtarisë së vet. Në këtë mënyrë, kryerja e transportit nga ana e shoqërisë “4 A –M” sh.p.k. të mallrave me kamionët e shoqërive qeradhënëse do të jetë në kushtet e kryerjes së transportit të mallrave me qira dhe për të tretë pa licencën përkatëse, transport i cili në zbatim të nenit 41 të ligjit “Për Transportet Rrugore” është i ndaluar. K.P.P gjykon se certifikata e mësipërme është pjesë e dokumenteve të nevojshme që vërtetojnë se mjeteve është në përdorim nga operatorët ekonomikë. Mungesa e këtij dokumenti, vërteton vetëm faktin se mjeteve mund të jetë në pronësi, por përdorimi i tij do të ishte i pamundur në zbatim të dispozitave të sipërcituara të Kodit Rrugor të RSh-së dhe të ligjit “Për Transportin Rrugor”.

III.1.9. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se kriteret për kualifikim vendosen që ti shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion realizimit me sukses të kontratës. Mungesa e dokumentacionit të mësipërm do të sillte pamundësinë e realizimit me sukses të kontratës, pasi mjetet nuk do të kishin mundësi të qarkullonin.

III.1.10. Në Kreun VIII, neni 74, “Bashkimi i operatorëve ekonomikë”, pika 1 e VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet: *“Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe në rast përzgjedhjeje edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi”*.

Në Kreun VIII, neni 74, pika 2 po këtu, parashikohet: *“Para dorëzimit të ofertës, bashkimi duhet të krijohet zyrtarisht, me një marrëveshje të noterizuar, ku të përcaktohen përfaqësuesi i grupit, përqindja e pjesëmarrjes së punës/shërbimit/furnizimit dhe elementet konkrete, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi. Pas krijimit të bashkimit të operatorëve ekonomikë, anëtarët e bashkimit caktojnë me prokurë përfaqësuesin e tyre për dorëzimin e ofertës. Kjo marrëveshje e shkruar dhe prokura duhet të dërgohen së bashku me kualifikimet dhe ofertën ekonomike, e cila duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi...”,* ndërsa në pikën 3 parashikohet: *“Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat ligjore, të parashikuara në nenin 45 të LPP dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje”*.

III.1.11. Sqarojmë se, referuar rregullave të prokurimit publik, përmbushja e kriterëve dhe kërkesave të autoritetit kontraktor duhet të bëhet nga secili anëtar i bashkimit në përputhje me përqindjen e shërbimeve të marra përsipër.

Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, dokumentacioni i paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “4 A-M” sh.p.k. & “Alba Konstruksion” sh.p.k., nuk është në përputhje me kërkesat e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, pasi numri i mjeteve të kërkuara nuk plotësohet nga secili anëtar i këtij bashkimi operatorësh ekonomikë në përputhje me përqindjen e përcaktuar në kontratën e bashkëpunimit. Sqarojmë se në kontratën e bashkëpunimit referuar legjislacionit në fuqi, operatorët ekonomikë të cilët vendosin të konkurojnë si një bashkim operatorësh ekonomikë në një procedurë prokurimi, duhet ta zyrtarizojnë këtë bashkim nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi, në të cilën kanë detyrimin të përcaktojnë pjesën e shërbimit, punës ose furnizimit që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi, ndërsa kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuar në këtë kontratë.

Nisur nga përqindja e përcaktuar në këtë kontratë, si edhe zërat e shërbimeve të marra përsipër nga secili prej anëtarëve, bëhet edhe verifikimi i përmbushjes së kërkesave dhe kriterëve të përcaktuara nga autoriteti kontraktor.

Sa më sipër, dokumentacioni i paraqitur në lidhje me përmbushjen e kriterit për mjetet, nuk është në përputhje me kërkesën e përcaktuar në dokumentat e tenderit, si edhe me ligjin dhe rregullat e prokurimit publik.

III.1.12. Sqarojmë se, referuar rregullave të prokurimit publik, përmbushja e kriterëve dhe kërkesave të autoritetit kontraktor, duhet të bëhet nga secili anëtar i bashkimit në përputhje me përqindjen e shërbimeve të marra përsipër. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, dokumentacioni i paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimes nuk është në përputhje me kërkesat e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, për mjetet,

për shkak të mangësive të evidentuara më sipër. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë dhe përvojën e duhur, për të zbatuar kontratën objekt prokurimi, si edhe janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit, në mënyrë që edhe vlerësimi të bëhet në përputhje me këtë dokumentacion, pasi ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme. Mosplotësimi qoftë edhe i një kriteri të vendosur nga ana e autoritetit kontraktor e bën ofertën e operatorit ekonomik të pavlefshme, si edhe përbën kusht për skualifikimin e tij nga procedura e prokurimit. Dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik ankimues në procedurën e prokurimit, nuk plotëson kërkesat e autoritetit kontraktor dhe nuk mund të konsiderohet i vlefshëm.

III.1.13. Gjithashtu, Komisioni i Prokurimit Publik, vlerëson se, autoriteti kontraktor nuk ka qenë në kushtet e nenit 53, pika 1, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar. Operatori ekonomik ankimues duhej të dorëzonte të gjithë dokumentacionin e ofertës në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit nga autoriteti kontraktor, në sistemin elektronik të prokurimeve para hapjes së ofertave. Nuk duhet të ofrohet apo lejohet asnjë ndryshim në përmbajtjen e ofertës, përfshirë ndryshimet në çmim apo ndryshime që synojnë të kthejnë një ofertë të pavlefshme në të vlefshme. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit, në mënyrë që edhe vlerësimi të bëhet në përputhje me këtë dokumentacion. Në rastin konkret, dokumentacioni i paraqitur nga ana e ankimuesit në këtë procedurë prokurimi, objekt shqyrtimi, nuk është i rregullt dhe për shkak të mangësive që ka nuk plotëson kërkesat e autoritetit kontraktor dhe si i tillë konsiderohet i pavlefshëm.

III.1.14. Komisioni i Prokurimit Publik, sqaron se, në rast se, operatori ekonomik ankimues do të kishte pretendime në lidhje me kërkesën e mësipërme të autoritetit kontraktor, ka patur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së ankesës mbi hartimin e dokumenteve dhe kriterëve të veçanta të kualifikimit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, parashikuar nga neni 63 pika 1/1 e LPP. Në nenin 63 pika 1/1 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar parashikohet se "*Në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë mund të ankohen pranë autoritetit kontraktor brenda 7 ditëve nga data e publikimit të njoftimit të kontratës në faqen në internet të Agjencisë së Prokurimit Publik. Me marrjen e ankesës me shkrim, autoriteti kontraktor pezullon vazhdimin e procedurës së prokurimit, derisa ankesa të jetë shqyrtuar plotësisht, përfshirë dhe nxjerrjen e një vendimi brenda 3 ditëve nga data e depozitimit të ankesës. Ndaj vendimit përfundimtar të autoritetit kontraktor mund të bëhet ankim në Komisionin e Prokurimit Publik, në përputhje me pikën 6 e në vijim të këtij neni*". Gjithashtu, kuadri ligjor, parashikon një sërë elementësh, si garanci për operatorët ekonomikë të cilët kanë paqartësi në lidhje me interpretimin e kërkesave të autoritetit kontraktor dhe/ose mënyrës së plotësimit të kriterëve kualifikuese. Në rast se operatori ekonomik ankimues do të kishte paqartësi në lidhje mbi plotësimin e kërkesës së mësipërme, ka në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së kërkesës për sqarime pranë autoritetit kontraktor deri në pesë ditë para dorëzimit të ofertave parashikuar nga neni 42 i LPP-së. Në nenin 42, pika 1 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, parashikohet se "*[...] Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë*

sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti kontraktor, i cili duhet t'i përgjigjet çdo kërkesë për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 5 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave. Autoriteti kontraktor duhet të përgjigjet brenda 3 ditëve nga depozitimi i kërkesës, në mënyrë që të bëjë të mundur dorëzimin e ofertës në kohë nga operatori ekonomik dhe, pa identifikuar burimin e kërkesës, duhet t'ia komunikojë sqarimin përkatës të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit [...]”.

Rrjedhimisht, sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues se arsyeja e skualifikimit “Së katërti AK ka kërkuar në kushtet e veçanta të kualifikimit si më poshtë cituar: 17. Ofertuesi duhet të paraqesë autorizim nga prodhuesi/ distributori i autorizuar nga prodhuesi me të cilin prodhuesi / distributori i autorizuar, autorizon ofertuesin të ofertojë këto mallra në këtë procedurë prokurimi. Autorozimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: Tel/fax/email. Ofertuesi të paraqesë, kataloge ose fragmente të katalogut të prodhuesit per listen e materialeve të mëposhtme që do të ofroje ku të paraqiten të dhenat teknike baze. 1. Bojra 2. Pllakat 3. Paisjet elektrike 4. Kamerat 5. Sistemin e kondicionimit 6. Ndricimi Në përmbushje të kriterëve të kërkuar në DST Komisioni i Vlerësimit të Ofertave vëren se një ndër pjesëtarët ekonomik përkatësisht “4AM”ka paraqitur në sistemin elektronik autorizim distributori për pajisjet elektrike nga Abbi-Esse,për pajisjet ndriçimi autorizim distributori nga Sali Elektrik,për pllakat autorizim distributor nga Delta sh.p.k ,për kamerat autorizim distributor Security Solution &Distribution ,për sistemin e kondicionimit autorizim distributori nga Superior Klima,për mallrat bojra autorizim prodhuesi lëshuar nga Deutchcolor. Në kontratën e bashkëpunimit nr.13 rep dhe 2 kol datë 04.01.2020 me anë të cilës është krijuar bashkimi i operatorëve ekonomikë përcaktohen qartë punët që do të marrë secili prej operatorëve ekonomike pjesëmarrës në bashkim. Operatori ekonomik Alba Konstruksion midis të tjerave ka marrë përsipër të realizojë zërat e punimeve në kapitullin A7 të preventivit objekt prokurimi (punime bojatisje në të cilën përfshihen lyerje tavane me bojë hidroplastike, lyerje mure të brëndshme me bojë hidroplastike). Në dokumentacionin e depozituar në sistemin elektronik të app-së nga operatori ekonomik Alba Konstruksion sh.p.k nuk rezulton të ketë paraqitur asnjë autorizim prodhuesi apo distributori për mallrat bojra. Vlen të theksohet se zërat e punimeve që kanë të bëjnë me punimet e bojatisjes janë marrë përsipër të kryhen nga shoqëria Alba Konstruksion sh.p.k dhe për rrjedhojë operatori ekonomik Alba Konstruksion sh.p.k duhej të paraqiste në sistemin elektronik autorizim prodhuesi apo distributori për mallrat bojra. Theksojmë se kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë dhe përvojën e duhur, për të zbatuar kontratën objekt prokurimi, si edhe janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit, në mënyrë që edhe vlerësimi të bëhet në përputhje me këtë dokumentacion, pasi ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme, në mbështetje edhe të pikës 3, të nenit 66 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, në të cilën përcaktohet se komisioni verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke

kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentat e tenderit. Në shtojcën 12 të DST shprehimisht parashikohet seRastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim. Pra, sa më sipër cituar dokumentacioni i paraqitur nga Operatori Ekonomik lidhur me pikën 17 është i paplotë dhe për rrjedhojë i pavlefshëm. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të pikës 5, të nenit 53, të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për “Prokurimin publik”, i ndryshuar dhe mbështetje të Kreu VII, neni 66, pika 3, të VKM nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e shpall të pavlefshme këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në DST”, nuk qëndron, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.2.1. Në dokumentat e tenderit, Shtojca 12, pika 17, nga ana e autoritetit kontraktor është përcaktuar kriteri: “17. Ofertuesi duhet të paraqesë autorizim nga prodhuesi/ distributori i autorizuar nga prodhuesi me të cilin prodhuesi / distributori i autorizuar, autorizon ofertuesin të ofertojë këto mallra në këtë procedurë prokurimi. Autorozimi duhet te permbaje te dhena te plota te prodhuesit si: Tel/fax/email. Ofertuesi te paraqese, kataloge ose fragmente te katalogut te prodhuesit per listen e materialeve te meposhtme qe do te ofroje ku te paraqiten te dhenat teknike baze.

1. Bojra
2. Pllakat
3. Paisjet elektrike
4. Kamerat
5. Sistemin e kondicionimit
6. Ndricimi

III.2.2. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të bashkimit të operatorëve ekonomikë ”Alba Konstruksion” sh.p.k. & “4 A-M” sh.p.k., rezulton se, është paraqitur dokumenti me emërtimin Kontratë Bashkim i Përkohshëm i Shoqërive ndërrjet shoqërisë “Alba Konstruksion” sh.p.k. dhe shoqërisë “4 A-M” sh.p.k., nga ku shoqëria “Alba Konstruksion” sh.p.k. merr përsipër për realizimin e objektit ë mësipërm në masën 28.76 % dhe shoqëria ” 4 A-M” sh.p.k. merr përsipër në masën 71.24 %.Konkretisht ndarja e punëve është përcaktuar në këtë kontratë bashkëpunimi dhe do të jetë si më poshtë vijon:

Shoqeria "ALBA KONSTRUKSION" sh.p.k. merr persiper kryerjen e punimeve sipas perqindjes se mesiperme te bashkepunimit per kapitujt e meposhtem te punimeve:

- Kapitulli A-I, PUNIME DHEU & PRISHJE & RRETHIMI
- Ne kapitullin A-2, PUNIME MURATURE zerat:
 - o I-2.64/2-Mur me tulle plota ne lartesi deri 3m me llaç perzier M 25
 - o 2-2.108/3-Ndertim muri me knauf t= 10 cm me dy shtresa, kunder lageshtires
- Kapitulli A-4, PUNIME SHITESASH
- Kapitulli A-5, PUNIME SUVATIMI DHE VESHJE
- Kapitulli A-6, PUNIME DRITARE DHE DYER
- Kapitulli A-7, PUNIME BOJATISJE
- Kapitulli A-8, PUNIME TE NDRYSHME
- Kapitulli A-9, PUNIME TARACE E PASHFRYTEZUESHME

- Kapitulli A-10, PUNIME TARACE E SHFRYTEZUESHME
- Ne kapitullin A-II, PUNIME FASADE XHAMI TE JASHTME DHE TE BRENDSHME zerat:
 - o 3-2.373-Vetrate xhami e temperuar per ndarje te brendshme xhami
 - o 5-Analize-Dyer rreshkitese xhami
 - o 6-Analize-Dyer rreshkitese xhami te brendshme
 - o 7-Analize-Parapet shkalle me xham + korimano druri
- Kapitulli B, SISTEMIMI I OBORRIT TE JASHTEM
- Kapitulli C.2, SISTEMI I MBROJTJES KUNDER ZJARRIT
- Kapitulli C.3, SISTEMI HIDRAULIK

Shoqëria “Alba Konstruksion” sh.p.k. do të kontribuojë edhe në asistencë teknike duke iu përmbytur përqindjes së saj.

Shoqëria “4 A – M” sh.p.k. merr përsipër kryerjen e punimeve sipas përqindjes së mësipërme të bashkëpunimit për të gjithë zërat e punimeve që nuk do të realizohen nga Alba Konstruksion shpk. Gjithashtu, është paraqitur edhe dokumenti Prokurë e Posaçme, sipas së cilës shoqëria “Alba Konstruksion” sh.p.k. është përfaqësuese e këtij bashkimi operatorësh ekonomikë.

III.2.3. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të bashkimit të operatorëve ekonomikë, rezulton se është paraqitur, në përmbushje të kriterit të sipërcituar si më poshtë vijon:

- I. Shoqëria “Alba Konstruksion” sh.p.k. nuk ka paraqitur asnjë autorizim prodhuesi ose distributori
- II. Shoqëria “4 A – M” sh.p.k. ka paraqitur:
 - Autorizim distributor për pajisje elektrike nga shoqëria “A BI ESSE” sh.p.k. për shoqërinë “4 A – M” sh.p.k.
 - Autorizim distributor ndriçimi nga shoqëria “Sali Elektrik” sh.p.k. për shoqërinë “4 A – M” sh.p.k.
 - Autorizim distributor kamera nga shoqëria “Security Solution & Distrubution” sh.p.k. për shoqërinë “4 A – M” sh.p.k.
 - Autorizim distributor kondicionim nga shoqëria “Superior Klima” sh.p.k. për shoqërinë “4 A – M” sh.p.k.
 - Autorizim distributori pllaka nga shoqëria “Delta” sh.p.k. për shoqërinë “4 A – M” sh.p.k.
 - Autorizim distributor bojra nga shoqëria “Deutcholor” sh.p.k. për shoqërinë “4 A – M” sh.p.k.

III.2.4. Në nenin 46, pika 1, gërma “b” të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese”.

III.2.5. Ndërsa në nenin 53, pika 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...”.

III.2.6. Nga verifikimi i ofertës së paraqitur nga bashkimi i përkohshëm i shoqërive të mësipërme rezulton se ka mangësi në plotësimin e kriterit për autorizimin e prodhuesit. Konkretisht konstatohet se shoqëria “Alba Konstruksion” sh.p.k. si anëtare e këtij bashkimi operatorësh ekonomikë nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion autorizim prodhuesi në lidhje me përqindjen e marrë përsipër dhe zërat e punëve të caktuar në kontratën e bashkëpunimit. Në këtë kontratë është përcaktuar se kjo shoqëri ka marrë përsipër edhe zërin A -7 Punime Bojatisje, ku për bojërat është caktuar të paraqitet autorizim prodhuesi, ndërkohë që nuk është paraqitur asnjë dokument i tillë, fakt ky i pranuar edhe nga vetë ankimesi i cili pretendon se ky kriter plotësohet nga i gjithë bashkimi i operatorëve ekonomikë.

III.2.7. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se kriteret për kualifikim vendosen që ti shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion realizimit me sukses të kontratës. Mungesa e dokumentacionit të mësipërm do të sillte pamundësinë e realizimit me sukses të kontratës, pasi mjetet nuk do të kishin mundësi të qarkullonin.

III.2.8. Në Kreun VIII, neni 74, “Bashkimi i operatorëve ekonomikë”, pika 1 e VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet: *“Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe në rast përzgjedhjeje edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi”*.

Në Kreun VIII, neni 74, pika 2 po këtu, parashikohet: *“Para dorëzimit të ofertës, bashkimi duhet të krijohet zyrtarisht, me një marrëveshje të noterizuar, ku të përcaktohen përfaqësuesi i grupit, përqindja e pjesëmarrjes së punës/shërbimit/furnizimit dhe elementet konkrete, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi. Pas krijimit të bashkimit të operatorëve ekonomikë, anëtarët e bashkimit caktojnë me prokurë përfaqësuesin e tyre për dorëzimin e ofertës. Kjo marrëveshje e shkruar dhe prokura duhet të dërgohen së bashku me kualifikimet dhe ofertën ekonomike, e cila duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi...”,* ndërsa në pikën 3 parashikohet: *“Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat ligjore, të parashikuara në nenin 45 të LPP dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje”*.

III.2.9. Sqarojmë se, referuar rregullave të prokurimit publik, përmbushja e kriterëve dhe kërkesave të autoritetit kontraktor duhet të bëhet nga secili anëtar i bashkimit në përputhje me përqindjen e shërbimeve të marra përsipër.

Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, dokumentacioni i paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “4 A-M” sh.p.k. & “Alba Konstruksion” sh.p.k., nuk është në përputhje me kërkesat e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, pasi dokumenti i autorizimit të prodhuesit për produktet e kërkuara nuk plotësohet nga secili anëtar i këtij bashkimi operatorësh ekonomikë në përputhje me përqindjen e përcaktuar në kontratën e bashkëpunimit.

Sqarojmë se në kontratën e bashkëpunimit referuar legjislacionit në fuqi, operatorët ekonomikë të cilët vendosin të konkurojnë si një bashkim operatorësh ekonomikë në një procedurë prokurimi, duhet ta zyrtarizojnë këtë bashkim nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi, në të cilën kanë detyrimin të përcaktojnë pjesën e shërbimit, punës ose furnizimit që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi, ndërsa kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuar në këtë kontratë.

Nisur nga përqindja e përcaktuar në këtë kontratë, si edhe zërat e shërbimeve të marra përsipër nga secili prej anëtarëve, do të bëhet edhe verifikimi i përmbushjes së kërkesave dhe kriterëve të përcaktuara nga autoriteti kontraktor.

Sa më sipër, dokumentacioni i paraqitur në lidhje me përmbushjen e kriterit për mjetet, nuk është në përputhje me kërkesën e përcaktuar në dokumentat e tenderit, si edhe me ligjin dhe rregullat e prokurimit publik.

III.2.10. Sqarojmë se, referuar rregullave të prokurimit publik, përmbushja e kriterëve dhe kërkesave të autoritetit kontraktor, duhet të bëhet nga secili anëtar i bashkimit në përputhje me përqindjen e shërbimeve të marra përsipër. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, dokumentacioni i paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimes nuk është në përputhje me kërkesat e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, për mjetet, për shkak të mangësive të evidentuara më sipër. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë dhe përvojën e duhur, për të zbatuar kontratën objekt prokurimi, si edhe janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit, në mënyrë që edhe vlerësimi të bëhet në përputhje me këtë dokumentacion, pasi ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme. Mosplotësimi qoftë edhe i një kriteri të vendosur nga ana e autoritetit kontraktor e bën ofertën e operatorit ekonomik të pavlefshme, si edhe përbën kusht për skualifikimin e tij nga procedura e prokurimit. Dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik ankimes në procedurën e prokurimit, nuk plotëson kërkesat e autoritetit kontraktor dhe nuk mund të konsiderohet i vlefshëm.

III.2.11. Operatori ekonomik ankimes duhet të dorëzonte të gjithë dokumentacionin e ofertës në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit nga autoriteti kontraktor, në sistemin elektronik të prokurimeve para hapjes së ofertave. Nuk duhet të ofrohet apo lejohet asnjë ndryshim në përmbajtjen e ofertës, përfshirë ndryshimet në çmim apo ndryshime që synojnë të kthejnë një ofertë të pavlefshme në të vlefshme.

Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit, në mënyrë që edhe vlerësimi të bëhet në përputhje me këtë dokumentacion. Në rastin konkret, dokumentacioni i paraqitur nga ana e ankimesit në këtë procedurë prokurimi, objekt shqyrtimi, nuk është i rregullt dhe për shkak të mangësive që ka nuk plotëson kërkesat e autoritetit kontraktor dhe si i tillë konsiderohet i pavlefshëm.

III.2.12. Komisioni i Prokurimit Publik, sqaron se, në rast se, operatori ekonomik ankimues do të kishte pretendime në lidhje me kërkesën e mësipërme të autoritetit kontraktor, ka patur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së ankesës mbi hartimin e dokumenteve dhe kritereve të veçanta të kualifikimit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, parashikuar nga neni 63 pika 1/1 e LPP. Në nenin 63 pika 1/1 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se *“Në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë mund të ankohen pranë autoritetit kontraktor brenda 7 ditëve nga data e publikimit të njoftimit të kontratës në faqen në internet të Agjencisë së Prokurimit Publik. Me marrjen e ankesës me shkrim, autoriteti kontraktor pezullon vazhdimin e procedurës së prokurimit, derisa ankesa të jetë shqyrtuar plotësisht, përfshirë dhe nxjerrjen e një vendimi brenda 3 ditëve nga data e depozitimit të ankesës. Ndaj vendimit përfundimtar të autoritetit kontraktor mund të bëhet ankim në Komisionin e Prokurimit Publik, në përputhje me pikën 6 e në vijim të këtij neni”*. Gjithashtu, kuadri ligjor, parashikon një sërë elementësh, si garanci për operatorët ekonomikë të cilët kanë paqartësi në lidhje me interpretimin e kërkesave të autoritetit kontraktor dhe/ose mënyrës së plotësimit të kritereve kualifikuese. Në rast se operatori ekonomik ankimues do të kishte paqartësi në lidhje mbi plotësimin e kërkesës së mësipërme, ka në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së kërkesës për sqarime pranë autoritetit kontraktor deri në pesë ditë para dorëzimit të ofertave parashikuar nga neni 42 i LPP-së. Në nenin 42, pika 1 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet se *“[...] Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti kontraktor, i cili duhet t'i përgjigjet çdo kërkesë për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 5 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave. Autoriteti kontraktor duhet të përgjigjet brenda 3 ditëve nga depozitimi i kërkesës, në mënyrë që të bëjë të mundur dorëzimin e ofertës në kohë nga operatori ekonomik dhe, pa identifikuar burimin e kërkesës, duhet t'ia komunikojë sqarimin përkatës të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit [...]”*.

Rrjedhimisht, sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

III.3. Në lidhje me pretendimet e tjera të bashkimit të operatorëve ekonomikë “4 A - M” sh.p.k. & “Alba Konstruksion” sh.p.k., për skualifikimin e padrejtë të tij, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se nuk kanë ndikim mbi fatin e çështjes, tashmë që nuk i janë pranuar disa prej pretendimeve të tij dhe gjendja faktike e juridike e këtij operatori nuk do të ndryshojë, por do të mbetet i skualifikuar nga procedura e prokurimit në fjalë, e për rrjedhojë duke mos përmbushur interes të ankimuesit, ndaj edhe nuk do të merren në shqyrtim, për ekonomi të procedurës.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të mos pranojë ankesën e bashkimit të operatorëve ekonomikë “4 A - M” sh.p.k. & “Alba Konstruksion” sh.p.k. për procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me nr. REF-44912-11-26-2019, me objekt “*Ndërtimi i Godinës së Re të Ujësjetës*”, me fond limit 480.000.551,56 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 06.01.2020, nga autoriteti kontraktor, Ujësjetës Kanalizime sh.a. Tiranë.
 2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
 3. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
 4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 133 Protokolli

Datë 03.02.2020

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Enkeleda Bega

Anëtar
Vilma Zhupaj

Anëtar
Lindita Skeja

Anëtar
Merita Zeqaj

Kryetar
Evis Shurdha